

# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5991  
E shtunë, 1 shkurt 2020  
çmimi 0.40 €

Deputetët e zgjedhur  
për herë të parë zotohen  
për Kuvend ndryshe dhe  
me integritet | FAQE 7



MË 2 SHKURT BËHEN 30 VJET TË LËVIZJES SË PAJTIMIT TË GJAQEVE  
NË KOSOVË 1990-1991 | FAQE 4-5

## PAJTIMI I GJAQEVE BASHKOI POPULLIN PËR LUFTË ÇLIRIMTARE



Pesë nismëtarët e pajtimit të gjaqeve në Kosovë, 30 vjet pas, kanë vlerësuar se falja e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave, përgjithësisht pajtimi ndërmjet shqiptarëve, ishte një prej periudhave më të rëndësishme të historisë. Myrvete Dreshaj-Baliu, Have Shala-Gërguri, Adem

Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj kanë rrëfyer për gazetën "Epoka e re" për ndikimin që kjo Lëvizje ka pasur në rrjedhat e mëpasshme të çlirimt, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Ata kanë deklaruar se ky pajtim e bashkoi popullin e Kosovës dhe e përgatiti përfundimtare



Në 23-vjetorin e rënies  
përkujtohen Zahir Pajaziti, Hakif  
Zejnullahu dhe Edmond Hoxha | FAQE 7

MË 3 SHKURT  
SEANCA E  
KUVENDIT  
PËR VOTIMIN  
E QEVERISË | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Makedoni  
Xheqisht-Tetovë  
Curë-Ferizaj  
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
MITROVICË

Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

[facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"](https://www.facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



### OPINION

DASHURIA SADO MAZOKISTE  
MIDIS ROMEOS (LV-SË) DHE  
XHULJETËS (LDK-SË) NË  
KOSOVË! | F. 11

Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA



SHQIPËRIA - KOSOVA  
NDËRMJET LINDJES DHE  
PERËNDIMIT | F. 8

Ismet  
HAJRULLAHU



FILOZOFIA POLITIKO-  
STRATEGJIKE E ZAHIR  
PAJAZITIT, HAKIF  
ZEJNULLAHUT DHE EDMOND  
HOXHËS | F. 11

Akademik prof. dr.  
Hakif BAJRAMI



### EKONOMI

NË KOSOVË U REGISTRUAN  
2 566 NDËRMARRJE | F. 9

BIZNESET DISKUTOJNË PËR  
PËRFITIMET NGA ZHVILLIMI I  
TREGUT TË KAPITALIT | F. 9

### SPORT

HADERGJONAJ: JAM SHUMË  
I LUMTUR QË JAM KËTU | F. 18



**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVO  
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Kim: Fryma e Skënderbeut dhe Washingtonit është këtu, mbajeni gjallë

**TIRANË, 31 JANAR** - Të premtën është mbajtur një takimi për reformën në drejtësi ku të pranishëm kanë qenë ministria Etilda Gjonaj, ambasadori i BE-së Luigi Soreca, si dhe Yuri Kim, ambasadore e ShBA-së.

Në fjalën e saj ambasadorja e ShBA-së, Yuri Kim është shprehur se të gjithë janë për të njëjtin qëllim, për t'i shërbyer Shqipërisë pavarësisht se nga cila kombësi janë. "Është e vështirë që të besoj që kam vetëm nëntë ditë në Shqipëri, në këto nëntë ditë kam takuar presidentin e Republikës, kryetarin Kuvendit dhe sot në mëngjes kryeministrin e Shqipërisë dhe

shumë ministra të tjera duke përfshirë ministren Gjonaj.

Kam pasur nderin të takohem me pjesën më të madhe prej jush dhe mund të dukem si një manjetofon i prishur pasi kam thënë të njëjtat gjëra duke ngulumuar se sa e rëndësishme është reforma në drejtësi.

Dua të falënderoj ambasadorin Soreca, jo vetëm për fjali e ngrrohta, por edhe për fjalin e shkëlqyer për reformën në drejtësi.

Ne jemi të gjithë në një krah. Për të gjithë ne që ndodhemi në këtë sallë, ndonëse jemi gjerman, amerikan, shqiptar jemi të gjithë shërbyes publik", ka thënë

ambasadorja amerikane. Ajo ka shtuar se në këtë reformë janë "krah për krah" me ne.

"Dhe, në fakt, për mua teksha shikoj këtë sallë me persona në fushën e drejtësisë mendoj për dy personalitet të jashtëzakonshëm. Për Skënderbeun dhe Washingtonin.

Unë besoj se fryma e Skënderbeut është prezent në Shqipëri, po ashtu mendoj se fryma e Washingtonit është këtu.

Edhe besoj plotësisht se si fryma e Skënderbeut dhe Washingtonit janë të gjallë këtu dhe në aty frymë dua që tu them që ta mbani të gjallë", tha Kim.



## Hapet vendkalimi Bellanoc - Stançiq, lehtëson lëvizjen mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut

Të premtën në mënyrë soleme është hapur vendkalimi kufitar me karakter ndërkombëtar Bellanoc - Stançiq, i cili do ta lidhë Maqedoninë e Veriut me Kosovën dhe në fillim do të shërbejë vetëm për qarkullim të udhëtarëve, por jo edhe të mallrave



**PRISHTINË, 31 JANAR** - Të premtën është lëshuar në përdorim vendkalimi kufitar Bellanoc - Stançiq, i cili do të lidhë Maqedoninë e Veriut me Kosovën, përkatësisht Komunën e Likovës me atë të Gjilanit.

Zyrtarë nga Kosova dhe ata nga Maqedonia e Veriut ishin të parët që e kaluan këtë pikë kufitar me letërnjoftime.

Vendkalimin e ri e hapi kryeministri i qeverisë teknike Oliver Spasovski, i cili e kaloi i pari kufirin. Spasovski tha se ky kalim i ri kufitar do të kontribuojë në rritjen e bashkëpunimit në mes dy vendeve. Përfunduan projektin që i jep një dimension të rëndësishëm politik përparimit të raporteve të mira ndërmjet shteteve tona", tha Spasovski.

"Republika e Maqedonisë së Veriut kanë marrëdhëniet të shkëlqyeshme. Projektet sikur ky i sotmi vetëm se thelojnë edhe më shumë këtë bashkëpunim. Përmirësojmë infrastrukturën mes dy vendeve tona, siç është autostrada Shkop-Bllacë. Në

të qytetarëve dhe mallrave. "Sot marrim pjesë në një ngjarje që tregon moment të ri domethënës për marrëdhëniet ndërmjet popujve tanë dhe raportet ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Hapja e kufirit Bellanoc-Stançiq është një arterie e re e ndërmjet dy vendeve. Përfunduan projektin që i jep një dimension të rëndësishëm politik përparimit të raporteve të mira ndërmjet shteteve tona", tha Spasovski.

"Republika e Maqedonisë së Veriut kanë marrëdhëniet të shkëlqyeshme. Projektet sikur ky i sotmi vetëm se thelojnë edhe më shumë këtë bashkëpunim. Përmirësojmë infrastrukturën mes dy vendeve tona, siç është autostrada Shkop-Bllacë. Në

kemi raporte të shkëlqyeshme dhe nuk kemi asnjë çështje të hapur", tha Spasovski.

Ndërsa zëvendëskryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj, tha se sot po realizohet një éndërr e kamotshme e banorëve të kësaj zone, si nga ana e Kosovës ashtu edhe nga ana e Maqedonisë së Veriut. "Kjo është një ditë shumë e veçantë që do të mbahet mend nga të dyja vendet. Hapja e kësaj pike

kufitare ka qenë një éndërr e kamotshme e qytetarëve të të dyja vendeve. Hapja e këtij kufiri është një përafrim edhe më i madh mes Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut", tha Enver Hoxhaj.

Objekti i pikës kufitar Bellanoc - Stançiq është ndërtuar me financa nga programi IPA i BE-së, në vlerë prej 1.2 milion eurosh, me synimin që ta lehtësojë bashkëpunimin mes

dy shteteve, të kontribuojë përlëvizjen e lirë të qytetarëve në këtë zonë kufitar, pasi banorët e rajonit të Kumanovës dhe ata të Gjilanit, në vazhdimësi janë ankuar që në mungesë të një vendkalimi kufitar, janë detyruar të udhëtojnë edhe nga njëqind kilometra përmes vendkalimit kufitar Bllacë, përtë arritur te familjarët e tyre që janë pak kilometra nga shtëpitë e tyre në komunën e Likovës.

## Basha zbulon planin e opozitës

**TIRANË, 31 JANAR** - Lideri demokrat Lulzim Basha ka konfirmuar se zgjedhjet do të prihen nga një qeveri transitore. "Ne i qëndrojmë propozimit tonë për një qeveri transitore jo vetëm për të kaluar këtë kritë. Është një qëndrim që ne nuk tèrhiqemi. Është i shkruar në dokumentin që u paraqit të hënën. 100 ditë para zgjedhjeve vendi të ketë një qeveri transi-

tore", tha Basha.

Rikthimin e papritur në tryezën e dialogut nuk e quan surprizë. "Ne këtë hap kaq të rëndësishëm për të cilin kemi luftuar për t'ju dhënë të drejta shqiptarëve që të votojnë të pakercënuar. Me kë do e bënim reformën zgjedhore, do linin Edi Ramën ta bënte me oligarkët dhe kriminelët apo me një Parlament fals. Pa diskutim që

ne jemi garancia që ky proces të bëhet ashtu siç duhet", tha ai. Historia e majit 2017 nuk do përsëritet sipas Bashës, pasi këtë herë ndërkombëtarët janë të ndërgjegjësuar si dikur përligjin e dekriminalizimit. "Është pjesë e dialogut që PD-ja ka me gjithë faktorin ndërkombëtar dhe të gjithë përfaqësuesit e tyre në Tiranë, ç'ka bëhet edhe më e rëndësishme në këto kohë

zhvillimesh, në veçanti reformën zgjedhore dhe të përpjekjes së PD-së dhe opozitës së bashkuar për t'i dhënë zgjidhje kësaj krize politike përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme", tha Basha.

I pyetur nëse fiton zgjedhjet Lulzim Basha do jetë kryeministër, po nëse i humb? "Unë nuk mendoj se shqiptarët preokupohen nga pyetje përfatim e një individu, kushdo qoftë ky edhe kryetari i opozitës", tha Basha.



# Më 3 shkurt seanca e Kuvendit për votimin e qeverisë

Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që më 3 shkurt në orën 11:00 të mbahet seanca plenare për votimin e qeverisë së re. Vendimi i Kryesisë së Kuvendit vjen pas kërkesës që ka bërë mandatari për formimin e qeverisë, lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për caktimin e seancës plenare. Kurti ende nuk ka arritur ta finalizojë marrëveshjen për koalicion me LDK-në, çka e bën të paqartë sigurimin e shumicës prej 61 votave në Kuvend për formimin e qeverisë së re

**EPOKA ERE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e së premtes të drejtuar nga Glauk Konjufca, kryetar, në të cilën ishin të pranishëm edhe kryetarët e grupeve parlamentare, ka shqyrtuar kërkesën e kandidatit për kryeministër, Albin Kurti, për thirrjen e seancës plenare të Kuvendit për votimin e përbërgjës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryesia në këtë mbledhje ka konstatuar se kërkesa i plotëson kushtet formale-juridike, prandaj vendosi që seanca të mbahet më 3 shkurt, në orën 11:00, me të vetmen pikë të rendit të ditës: zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, gjatë një paraqitjeje për gazetarë pas mbledhjes së kryesisë, shprehur optimizëm për arritjen e një marrëveshjeje midis LDK-së dhe LV-së para datës 3 shkurt. "Bisedimet po vazhdojnë, nuk ka ende një marrëveshje përfundimtare. Unë jam shumë optimist që marrëveshja do të bëhet dhe që askush nuk do të mund ta ndalë formimin e qeverisë Kurti", ka thënë

Konjufca, duke bërë me dije se nuk do të japë dorëheqje nga kjo pozitë. "Nuk mendoj që në Kosovë është koha e dorëheqjeve, por e emërimeve", ka thënë Konjufca.

Të premten në lidhje me situatën e fundit politike në vend, kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës ka mbajtur takim.

Pas takimit, nënqryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se do t'i vazhdojnë takimet me LV-në për të negociuar përritjen e një marrëveshje, duke mos hequr dorë nga posti i kryetarit të Kuvendit të Kosovës. "Ne kemi arritur për t'i përmbyllur të gjitha çështjet që na kanë dalluar në një dokument voluminoz, i cili është marrëveshje politike e përgatitur. Jemi në përpjekje që sot, nesër e pasnesër, t'i realizojmë angazhimet tona përritjet e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, i cili post është i zënë, Kuvendi më 26 dhjetor e zgjodhi Glauk Konjufcën edhe me votat e deputetëve të LDK-së. Lëvizja Vetëvendosje konsideron se rreth këtij posti nuk ka kthim prapa, se duhet t'i mbetet Glauk Konjufcës, kurse LDK-ja kërkon që ai të tjeriqet dhe t'i bëjë vend kandidatit të LDK-së. Nga ana tjetër, LV-ja ofron si kompensim një post shtesë ministrit, kurse LDK-ja mendon se me këtë nuk sigurohet bilanci i duhur i ndarjes së pushtetit. As ambasadorët e Quintit, që kësaj



here nuk kanë qenë komplet në numër, nuk kanë sjellë ndryshim, edhe ashtu kanë qenë vetëm vëzhgues, nuk kanë ndikuar ose diriguar me vendimmarrjen", ka thënë Malqi për "Epokën e re". Ai ka vlerësuar se tërheqja nga pozicionet aktuale nuk do të thotë humbje për asnjërin parti. "Shikuar nga jashtë, sepse nuk e dimë se si është atmosfera brenda bisedimeve, dallimet në qëndrime vërtet nuk janë të mëdha, dhe besoj se do të mund të zgjidheshin ditëve në vijim", ka thënë ai. Analisti tjetër politik, Bedri Islami, ka thënë për gazeten "Epoka e re" se bashkimi në mes të LV-së dhe LDK-së do të jetë i vështirë por, edhe nëse bëhet, do të jetë i mundimshëm. "Unë personalisht do të isha për një qeveri teknike, gjithëpërfshirëse, të kufizuar në kohë, të themi njëvjeçare, që do t'i përgatiste zgjedhjet e reja, por në të cilën të mos përfshihej PDK-ja, e cila ka zgjedhur rrugën e qëndrimit në opozitë dhe mendoj se duhet të jetë në opozitë. Ajo duhet ta shërojë veten për të qenë pjesë e shërimit të plagëve të Kosovës",

ka deklaruar Islami. Sipas Kushtetutës së Kosovës, nëse ai nuk siguron të paktën 61 vota sa duhen për miratimin e qeverisë, atëherë presidenti "emëron kandidatin tjetër për kryeministër", i cili nga marrja e mandatit do të ketë dhjetë ditë për formimin e qeverisë.

Nëse as kandidati tjetër nuk siguron formimin e qeverisë, vendi shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë janë mbajtur më 6 tetor 2019. Ato u nxitën nga dorëheqja e kryeministrit Ramush Haradinaj pasi mori ftesë për t'u intervistuar nga Gjykata Speciale në Hagë. Pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës më 26 dhjetor, presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, më 20 janar ka mandatuar liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, për postin e kryeministrit. Sipas Kushtetutës, prej momentit që presidenti mandaton kandidatin për kryeministër nis edhe rrjedhja e afatit kushtetues prej 15 ditësh për krijimin e ekzekutivit.

## Haradinaj dhe Konjufca presin në takim shefin e ri të EULEX-it

**PRISHTINË, 31 JANAR (ER)** - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim njohës shefin e ri të EULEX-it, Lars Gunnar Wigermark. Me këtë rast, Haradinaj e ka uruar Lars Gunnar Wigermark për detyrën e re dhe ka shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit në proceset e interesit të përbashkët mes EULEX-it dhe institucioneve të vendit.

Haradinaj e ka njoftuar shefin e ri të EULEX-it për zhvillimet e sundimit të ligjit dhe ato të sigurisë në vend. "Qeveria e Kosovës dështron e saj janë të

përkushtuara në rrugën përsundimin e ligjit", është shprehur Haradinaj, i cili ka theksuar se sukseset e EULEX-it dhe të Kosovës janë të përbashkëta dhe se Kosova është e hapur përbashkëpuni e përsorës së EULEX-it. "Lars Gunnar Wigermark, me të cilin ka diskutuar përritjet e këtij misioni në sundimin e rendit e të ligjit në Kosovë dështron e saj mbështetjen ndaj



institucioneve të saj, veçanërisht në sferën e gjyqësorit. Konjufca ka theksuar se sundimi i ligjit në të gjitha nivelet duhet të jetë prioritet i institucioneve të Kosovës, ndërsa bashkëpunimi me misionet ndërkombëtare, siç është EULEX-i, është i nevojshëm.

Nga ana e tij, Lars-Gunnar Wigermark konfirmoi gatishmërinë e misionit që ai drejton përritjet e mbështetur Kosovën në ballafaqimin e mëtejmë të sfidave ekzistuese në fushën e sundimit të ligjit, në kuadër të procesit euro-integrues të Kosovës.

Nga motoja e Adem Demaçit „Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimit, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit“, të shprehur në romanin „Gjarpit e gjaku“, e deri te falja e 1169 gjaqeve, 477 plagosjeve dhe 865 ngatérresave, autori i kësaj vepre me vlera të shumëfishta nxjerr përparrë lexuesit përpjekjet e jashtëzakonshme për ta çliruar popullin shqiptar nga gjarpérinjtë e vërtetë, si parakusht për një mobilizim të përgjithshëm për çlirimin kombëtar.

Bardhyl Mahmuti, politolog

Atje ku nuk ka thjeshtësi, nuk ka as madhështi, thotë një kryepenë botërore. Një nga të pesë nismëtarët autentikë të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve (1990-1991) që preferuan thjeshtësinë për madhështinë kombëtare, është autor i këtij libri të vonuar tridhjetë vjet, Lulëzim Etemaj. Kjo lëvizje na transformoi në një shkallë më të lartë qytetërimi. Me pajtimin, unititetin dhe solidaritetin që solli ajo, krijoj, në të vërtetë, parakushtet përluftën triumfuese çlirimtare, falë këtij boshti qytetërues dhe drejtimit të saktë gjepolitik.

Muhamed Mavraj, publicist

LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE  
NË KOSOVË (1990-1991)

LULËZIM ETEMAJ



LËVIZJA E PAJTIMIT TË GJAQEVE  
NË KOSOVË  
(1990-1991)



Më 2 shkurt bëhen 30 vjet të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991

# Pajtimi i gjaqeve bashkoi popullin përluftë çlirimtare

Pesë nismëtarët e pajtimit të gjaqeve në Kosovë, 30 vjet pas, kanë vlerësuar se falja e gjaqeve, plagëve dhe ngatérresave, përgjithësisht pajtimi ndërmjet shqiptarëve, ishte një prej periudhave më të rëndësishme të historisë. Myrvete Dreshaj-Baliu, Have Shala-Gërguri, Adem Grabovci, Brahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj kanë rrëfyer për gazeten “Epoka e re” për ndikimin që kjo Lëvizje ka pasur në rrjedhat e mëpasshme të çlirimt, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Ata kanë deklaruar se ky pajtim e bashkoi popullin e Kosovës dhe e përgatiti përluftën çlirimtare

burgu shtëpiakë mijëra persona. Ndërkaq, në aspektin politik kombëtar, Lëvizja e Pajtimit te Gjaqeve, sipas tyre, arriti ta bashkojë popullin shqiptar dhe të përgatisë përluftë çlirimtare.

**Myrvete Dreshaj-Baliu:**  
**Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve, ndër lëvizjet më unike në historinë kombëtare**

Myrvete Dreshaj-Baliu, një nga pesë nismëtarët e pajtimit të gjaqeve në Kosovë, ka deklaruar se Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve është ndër lëvizjet më unike në historinë kombëtare. Ajo në këtë 30 vjetor ka theksuar se edhe në rrethana të sotme popullit tonë do t'i duhej shumëcka nga kjo frysë dhe në mënyrë të veçantë do t'i duhej skenës sonë politike. “Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve është ndër lëvizjet më unike në historinë kombëtare. Edhe sot, pas tridhjetë vjetësh, LPG mbetet fryma më unifikuese e zhvillimeve tona historike. Sigurisht, edhe në rrethana të

sotme, popullit tonë do t'i duhej shumëcka nga kjo frysë, dhe në mënyrë të veçantë do t'i duhej skenës sonë politike. Kemi nevojë edhe një herë si komb ta kujtojmë Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve gjatë viteve të veçanta 1990-1991 dhe masivizimin e homogenitetit e saj më të fuqishëm nacional, të realizuar ndonjëherë në lëvizjet tona përluftës së ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të ishte mirë të na udhëhiqte edhe në perspektivën tonë për ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe raporteve tona brendashqiptare”, ka thënë Myrvete Dreshaj-Baliu.

**Have Shala-Gërguri: Falja e gjaqeve, shkallë e re e vetëdijes së popullit shqiptar**

Have Shala-Gërguri ka treguar përgatitjen përluftës së popullit shqiptar

gjaqeve. "Ne nuk mund të qëndronim indiferentë përballë këtij cinizmi kaq të pacipë. Kësaj djallëzie të pushtetit duhej kundërvënë. Kjo ishte një kërkesë e pakontestueshme në qenien tonë. Dhe nisma mori rrugë. E bëmë hapin e vendimtar: u mblohdhëm ne të gatshmit për të vepruar. I caktuam rastet ku duhej intervenuar. Filluan me marrjen besë në fshatin Lumbardh, me pajtimin e hasmërisë në Raushiq, me faljen e gjakut në Berliq. Aty gjakmarrjes iu vu guri i varrit. Gjakmarrja aty s'mund të shkruante më epitaf. Pastaj rasti i katërt, pastaj rasti tjetër... pastaj vullneti i një populli të vetëdipesuar për t'i thënë jo gjakmarrjes, jo krenarisë vrastare, jo vargonje të pakuptimit", është shprehur ajo.

Më tej, ajo ka vlerësuar se ky aksion e ka mësuar se kur fillon një dialog shoqëror, kur në të përfshihet një shumicë, kur të vuajturve u dëgjoen vuajtjet dhe shprehet bashkëdhembje, mund të lëvizet shumë përrpara. "Perceptimi shoqëror për familjen që falë është sot dukshëm më pozitiv se ç'ka qenë para Aksionit për Pajtim. Individ që vret nuk konsiderohet më as guximtar, as nuk është i nderuar në shoqëri. Ky është një ndryshim i rëndësishëm kualitativ, që flet për atë se gjakmarrja si koncept ka filluar të hiqet nga të menduarit tonë. Porosia e këtij Aksioni edhe sot e kësaj dite është që drejtësia nuk guxon - duke heshtur dhe duke neglizhuar - të krijojë hapësirë që individë të përfshirë në konteste të ndryshme ta marrin vetë ligjin në dorë", ka deklaruar ajo.

### Grabovci: Përveç pajtimit, qëllimi ishte ta bashkojmë popullin për luftë

Edhe nismëtari tjetër i aksionit për pajtimin e gjaqeve, Adem Grabovci, ka treguar se, përveç

pajtimit, kjo nismë kishte për qëllim bashkimin e popullit dhe përgatitjen e tij për luftë çlirimtare. "Para 30 vjetëve kemi pasur një realitet krejt tjetër në Kosovë, shqiptarët shprehnin pakënaqësitet ndaj regjimit përmes protestave dhe formave të ndryshme. Për ta mbajtur gjallë atë aktivitet duhet të ndërmerrnim diçka. Ishim të vetëdijshëm se ai aktivitet nuk mund të mbahet gjallë vetëm me demonstrata. Në këtë mënyrë e kemi menduar idenë e fillimit, pajtimit të gjaqeve. Qëllimi i kësaj lëvizje nuk ka qenë vetëm pajtimi i gjaqeve, po kishim për qëllim të depërtojmë në masë dhe të krijojmë një front të bashkuar në popull. Dëshironim ta përgatisnim popullin për luftë të armatosur, sepse e kishim të qartë se ishin konsumuar të gjitha mjetet e tjera paqësore për arritjen e qëllimeve tonë", ka thënë Grabovci. "Me lëvizjen tonë ne kemi arritur dy qëllime. Së pari e kemi luftuar një të keqe e cila kishte sjell pasojë shumë të mëdha për popullin e Kosovës. Dhe, së dyti, arritëm të krijojmë një front të përbashkët, një unifikim të popullit, duke e përgatitur për proceset e mëvonshme. Këtë sukses e kemi arritur për një kohë të shkurtër, sepse qëllimi ynë ka qenë tepër fisnik dhe i sinqertë", është shprehur ai.

Më tej, Grabovci ka treguar se që në fillim të aksionit i kishin ndarë detyra se kush duhet të takojej me intelektualë e kush me qytetarë. Ai ka thënë se gjatë javës grupet e punës identifikonin rastet duke biseduar me ato familje, kurse të shtunave dhe dielave kanë bërë pajtimin e familjarëve, ku iu bashkoheshin profesorët dhe intelektualët e ndryshëm. "Kemi pasur rast që kur kemi shkuar ta kërkojmë faljen e gjakut, ka ndodhur që në fillin na i kanë falur plumbat e armës të cilët i kanë ruajtur për ta marrë gjakun, pastaj na e kanë



shtrirë dorën e pajtimit për ta falur gjakun. Ato kanë qenë çaste jashtëzakonisht emocionuese për ne. Kemi rast që kanë shkuar grupe të ndryshme të njerëzve për t'i pajtuar, por nuk kanë arritur t'i pajtojnë. Ndërsa, neve na ka kanë pritur krahëhapur. Më kujtohet një loke në Lug të Baranit kur na ka thënë: Ejani pëllumbat e nanës, se juve jam duke ju pritur", ka thënë Grabovci.

**Brahim Dreshaj:  
Aksioni i pajtimit e  
bashkoi popullin**

Edhe nismëtari tjetër i aksionit, Brahim Dreshaj, ka folur për

rëndësinë e aksionit në ngritjen e vetëdipesë kombëtare. Ai ka thënë për gazetën se ky aksion e bashkoi popullin e Kosovës. "Rëndësia e kësaj lëvizje ka qenë jashtëzakonisht e madhe. Sepse shqiptarët në atë kohë, siç e dimë të gjithë, ishin të robëruar dhe para se të futemi në luftë për çlirimin e Kosovës, është dashur të ndodhë një pajtim dhe bashkim i popullit. Në atë bashkim është dashur të marrim pjesë të gjithë, në të kundërtën suksesi mund të ishte jo i plotë. Ky pajtim e ka bashkuar popullin, sepse kemi rrëth 2 000 raste të familjeve që janë pajtuar, duke falur gjaqe, plagë dhe ngatërresa. Pra, rëndësia e

lëvizjes për pajtim ka qenë e madhe, sepse kemi arritur ta unifikojmë popullin dhe ta përgatisim që të futemi në luftë të bashkuar, pa hasmëri mes vete dhe drojë nga hakmarrja", ka thënë Dreshaj. Më pas, ai ka treguar se shumë bashkëveprimtarë të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve kanë marrë pjesë aktivisht në luftë apo kanë qenë përkrahës të saj në forma direkte. "Në të njëjtën kohë pjesë dërmuese e asaj lëvizje, përfshirë një pjesë të madhe të atyre që shtrinë dorën e pajtimit, kanë marrë aktivisht pjesë në luftën çlirimtare. Disa bashkëveprimtarë të aksionit kanë rënë edhe dëshmorë, siç është rasti me Meh Ukën, si dhe Xhemajl Fetahaj, i cili është vrarë me pushkë në dorë", ka thënë Dreshaj.

### Lulëzim Etemaj: Ndjenja e krenarisë sot, si para 30 vjetësh

Lulëzim Etemaj ka thënë se Lëvizjen e Pajtimit të Gjaqeve, në planin personal, e sheh me shumë emocion. "Ndjenja e krenarisë, me bashkënișmëtarët e pajtimit të gjaqeve, e falenderimit dhe mirënjojsh për të gjithë ata që e shtrinë dorën e pajtimit, nuk është zbeetur për asnjë çast gjatë këtyre 30 vjetëve. E tillë është edhe në këtë 30-vjetor", është shprehur ai. Etemaj ka thënë se Kosova do të çlirohej gjithsesi edhe pa pajtimin e gjaqeve në vitet 1990-1991, por ka vlerësuar se pa atë pajtim, bashkim dhe solidaritet shqiptar, edhe formimi i UÇK-së, si faktori kryesor i çlirimtës së Kosovës, qëmimi i lirisë, do të ishte tepër më i lartë. "Po ashtu, llogaris që pa pajtimin e gjaqeve dhe luftën çlirimtare do të ishte shumë e diskutueshme se vërtet në këtë 30-vjetor Kosova do të ishte shtet i pavarur e sovran, që pas vetes ka 11 vjet", ka deklaruar Etemaj.



## Përkujtohen dëshmorët Fatmir Kërleshi e Xhevati Hoxha

**GJAKOVË, 31 JANAR (ER)** - Të premten në Gjakovë janë përkujtuar dëshmorët Fatmir Kërleshi e Xhevati Hoxha, të cilët kanë rënë heroikisht në demonstratat e vitit 1990, në kundërshtim të okupimit klasik të Serbisë mbi Kosovë. Në nderim të këtyre dëshmorëve, në vendin e rënies, në lagjen "Gecë" të Gjakovës, është vendosur një pllakë përkujtimore si dëshmi për sakrificën që breza të tërë kanë dhënë për lirinë dhe

pavarësinë e Kosovës. Zbulimin e kësaj pllakte, krahas familjarëve dhe bashkëveprimtarëve të dëshmorëve, e ka bërë edhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, i cili në fjalën e tij, mes të tjera, ka thënë se rënia heroike e dy djemve të mirë të Gjakovës, Fatmirit e Xhevatin, ishte fillimi i ri ngritjes së popullit të Kosovës, në këtë rast edhe të Gjakovës, për angazhimin konkret përlirinë, angazhim që

edhe e solli lirinë pas nëntë vjetësh jo edhe aq të lehtë. Në këtë ceremoni përkujtimore kanë folur edhe kryetari i Shoqatës së Intelektualëve "Jakova", Ruzhdi Sefa dhe familjarë të dëshmorëve Fatmir Kërleshi e Xhevati Hoxha. Në nderim të dy dëshmorëve, paraprakisht një delegacion nga Komuna e Gjakovës ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora me lule në Varrezat e Dëshmorëve.



## Stacioni Policor në Han të Elezit shpallet më i miri në kuadër të Drejtorisë Rajonale Policore



**HANI I ELEZIT, 31 JANAR (ER)** - Në ambientet e Komunës së Hanit të Elezit, Stacioni Policor në këtë komunë ka prezantuar reportin e punës për vitin 2019. Prezantimi i këtij rapporti ka filluar me një minutë heshtje për ta nderuar pjesëtarin e Policisë së Kosovës, Sami Thaqi, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës në fshatin Zhur të Prizrenit. Në këtë ngjarje informuese ishte i pranishëm edhe kryetari i Hanit të Elezit, Rufki Suma, përfaqësuesit nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj etj. Komandanti i Stacionit Policor në Han të Elezit, toger Nuhi Dema, para të pranishmëve ka paraqitur reportin me të dhënat statistikore. Sipas tij, në vitin 2019 janë regjistruar gjithsej 103 raste ose përshtatë raste më pak se në vitin 2018. Duke u bërë analizë të gjithë

indikatorëve, toger Dema ka thënë se natyra e rasteve të raportuara nuk ka cenuar seriozisht rendin dhe qetësinë publike. Në këtë kontekst, ai ka falenderuar Komunën e Hanit të Elezit, institucionet e tjera publike dhe banorët e kësaj komune për kontributin e tyre që rezultatet e polisë të jenë pozitive. Ndërsa drejtori rajonal i Policisë së Kosovës në Ferizaj, kolonel Emin Beqiri, ka bërë me dije se në bazë të këtij reporti Stacioni Policor në Han të Elezit është shpallur më i miri në kuadër të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Ferizaj. Në anën tjetër, kryetari i Hanit të Elezit, Rufki Suma, pasi ka uruar komandantin Dema dhe pjesëtarët nga Stacioni Policor në këtë komunë përshtatë raste më pak se në vitin 2018. Duke u bërë analizë të gjithë

## Identifikohen nevojat për investime në lokalitetet e komunës së Vitisë

**VITI, 31 JANAR (ER)** - Komuna e Vitisë, në bashkëpunim me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), kanë mbajtur të premten një takim me përfshirje së kërkave të qytetarëve të dëgjimet buxhetore. Përfaqësuesit e këshillave të fshatrave kanë paraqitur nevojat që kanë në lokalitetet e tyre si prioritet për investime, ndërkohë që si kërkese e domosdoshme është identifikuar më së shumti mungesa e ujit të pijshëm. Po në këtë takim është diskutuar edhe për projektet e realizuara

rrëth përfshirjes së kërkave të qytetarëve të dala nga dëgjimet buxhetore. Përfaqësuesit e këshillave të fshatrave kanë paraqitur nevojat që kanë në lokalitetet e tyre si prioritet për investime, ndërkohë që si kërkese e domosdoshme është identifikuar më së shumti mungesa e ujit të pijshëm. Po në këtë takim është diskutuar edhe për projektet e realizuara

gjatë vitit 2019 dhe projektet që pritet të realizohen për gjatë vitit 2020. Takimi i së premtes është mbajtur si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm që ka KDI me zyrtarët komunalë dhe këshillat e fshatrave të Vitisë në raport me implementimin e projektit të kësaj organizate përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve.



## Më 4 shkurt mbahet konferanca 'Të rinjtë në agrobiznes-regjioni ekonomik lindor'



**KAMENICË, 31 JANAR (ER)** - Komuna e Kamenicës ka ftuar për të martën, më 4 shkurt, të rinjtë nga kjo komunë të marrin pjesë në konferencën e organizuar nga projekti "Të rinjtë në agrobiznes-regjioni ekonomik lindor", e cila do të mbahet në Gjilan. "Ky projekt

është i financuar nga Bashkimi Evropian, menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me Komunën e Kamenicës dhe komunat e tjera nga Regjioni Lindor. Qëllimi kryesor i kësaj konfer-

ence është prezantimi i programave në mbështetje të fermërve të Regionit Lindor. Konferanca do të mbahet të martën (më 4 shkurt 2020), në Sallën e Kuvendit në Komunën e Gjilanit, duke filluar nga ora 10:00", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

# Në 23-vjetorin e rënies përkujtohen Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha

**PRISHTINË, 31 JANAR (ER)** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, me rastin e 23-vjetorit të rënies së heronjeve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, të premten ka bërë homazhe te shtatorja e heroit të Kosovës, Zahir Pajaziti. Presidenti Thaçi ka thënë se sot është përvjetori i rënies heroike të një prej komandantëve legjendarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Zahir Pajazitit, si dhe dy bashkëluftëtarëve të tij, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut. "Është përvjetori i njerëzve që kanë bartur mbi supet e veta fillimet e organizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të këtij projekti madhor dhe të shenjtë të kombit tonë, që solli lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka thënë Thaçi.

Kreu i shtetit tha se sot nderojmë me pietetin dhe respektin më të lartë shtetëror jetën dhe veprën heroike të këtyre komandantëve dhe të

gjithë luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ranë në istikame të luftës. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konufca, së bashku me disa deputetë të Kuvendit, ka bërë homazhe pranë shtatores së heroit të kombit Zahir Pajaziti, në 23-vjetorin e rënies të tre dëshmorëve, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu e Edmond Hoxha. "Pas rënies dhe heroizmit të Zahir Pajazitit me shokë, mijëra djem e vajza të Kosovës ishin të mbushur plot me vullnet dhe gatishmëri për aksion e për luftën tonë çlirimtare. Kjo gatishmëri e rinisë është garancia kryesore për çlirimin e një populli", ka thënë Konufca për mediat, pas ceremonisë së homazheve.

Gjithashtu, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe te shtatorja e eroit, Zahir Pajaziti në Prishtinë dhe te vendi i rënies së tre heronjeve, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond



Hoxha, në Pestovë të Komunës së Vushtrrisë, në 23-vjetorin e rënies së tyre.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, gjatë homazheve te shtatorja e Zahir Pajazitit, tha se

komandanti Zahir Pajaziti ishte një nga themeluesit e UÇK-së që ka lënë pas vetes vërtet një shembull të një luftëtarit të zotë e të një bashkëluftëtarit të mirë. Haradinaj, ministri i FSK-së,

Rrustem Mustafa, dhe kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, bënë homazhe te lapidari i rënies së heronjeve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha në Pestovë të Vushtrrisë.

## Deputetët e zgjedhur për herë të parë zotohen për Kuvend ndryshe dhe me integritet

EPOKA ERE Faton DRËMAKU

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të premten diskutimin publik "Kuvendi në sytë e të rinxive: Sfidat që duhet të adresohen nga legislatura e VII-të", pjesë e të cilët ishin deputetët e zgjedhur për herë të parë në Kuvendi e Kosovës në ballafaqim me të rinx.

Deputetët e rinj e kanë konsideruar të domosdoshëm ndryshimin e qasjes politike në Kuvend dhe janë zotuar se do të instalojnë një standard të ri të funksionimit të këtij institucionit, që nuk do të jetë i karakterizuar me gjuhë denigruese, konfrontime, por që do ta ketë në qendër interesin qytetar. Ata kanë theksuar se ato do t'i përfaqësojnë interesat qytetare dhe jo partiake dhe se do të jenë të zëshëm në kërkim të llogaridhënieve nga ana e ekzekutivit.

Në hapje të këtij diskutimi, drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka theksuar se KDI-ja për vite të tëra është duke bërë monitorimin e punës së Kuvendit, duke ndikuar edhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënieve së këtij institucionit. Gjithashtu, ka bërë me dije se KDI-ja është angazhuar që ta rrisë edhe pjesëmarrjen qytetare në këtë proces, për çka ka angazhuar



rreth 100 studentë që të përfshihen në procesin e monitorimit të këtij institucionit. Kurse deputeti Artan Abrashi (LV) ka potencuar se deputeti i kësaj legislature ka përgjegjësi shumë të madhe për shkak se, sipas tij, qytetari i Kosovës më 6 tetor ka votuar për ndryshim të vetëdijes politike. "Vullneti i qytetarëve ka të bëjë me një kërkësë për standard të ri politik... ne si deputetë duhet të angazhohemi ta ruajmë integritetin e institucionit që përfaqësojmë", ka thënë ai, duke shtuar se Kuvendi duhet të ketë një rol më të shtuar, në mbikëqyrje të ekzekutivit dhe, gjithashtu, të tregohet përkushtim për respektim të pushteteve.

Deputeti Besian Mustafa (LDK)

ka theksuar se është bazike për se cilin deputet që të ndërtojë dhe ruaj mirëbesimin me qytetarin duke mos e sfiduar atë. Ai ka konsideruar se kjo legislature duhet të funksionojë pa ngjyrime partiale dhe të fokusohet në mbikëqyrjen e ekzekutivit ashtu siç e kërkon përgjegjësia që është marrë nga qytetari. "Ne marrim mirëbesimin nga qytetarët dhe e përkthejmë në mbikëqyrjen që ia bëjmë qeverisë, si Kuvend në tërësi", ka shtuar ai, duke theksuar se fusha në të cilën do të jetë më i fokusuar është ekonomia.

Deputetja Eliza Hoxha (PDK) ka theksuar nevojën për rritje të llogaridhënieve ndaj qytetarëve duke vlerësuar se sistemi i ndarjes së vendit në zona

zgjedhore do të mundësonë një lidhje direkte mes deputetit dhe qytetarit dhe do ta rriste llogaridhëni. Hoxha e sheh me shqetësim edhe aspektin e gjuhës dhe komunikimit publik, që shpesh ka thënë se karakterizohet me linçime të pabaza ndaj individëve të ndryshëm. "Ne mund të mendojmë ndryshe, por duhet të dimë që për kauza të mëdha duhet të jemi bashkë", ka shtuar ajo. Hoxha ka theksuar se gjatë kësaj legislature do të jetë më tepër e fokusuar në çështjet e mjedisit edhe të planifikimit urban.

Kurse deputetja Albena Reshitaj (AAK) ka vlerësuar se transparenca dhe llogaridhënia mungojnë në Qeveri dhe Kuvend dhe në të gjitha institucionet publike.

Madje, sipas saj, duhet një vetëdijesim më i lartë qytetar që do të kontribuonte në një kritikë më të shëndoshë që do t'i obligonte institucionet të jenë llogaridhëne dhe transparente. Kuvendi ka thënë se duhet ta ketë një fokus çështjen e rregullores së re të punës si dhe të jetë më transparent në procesin e plotësim-ndryshimit të ligjeve. Reshitaj ka theksuar se gjatë këtij mandati do të jetë më tepër e fokusuar në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë.

Deputetja Mirlinda Sopi-Krasniqi (AKR-Nisma) gjithashtu ka theksuar se deri më tanë Kuvendi është perceptuar si një arenë konfrontimesh që është shoqëruar nga një gjuhë joadekuante. Ajo ka potencuar se deputetët nuk do të duhej të kenë ndarje partiake, por të jenë të fokusuar në përfaqësim të popullit dhe të punojnë për realizim të interesave të tyre. Ajo ka theksuar se numri i madh i deputetëve të rinj përbën "një ekip të mirë", që beson se do të bëjnë një ndryshim pozitiv në Kuvend. Ndërkohë shëndetësia dhe sporti ka thënë se do të jenë pikat e saj të fokusit.

Ky diskutim u organizua në kuadër të serisë së diskutimeve "Kuvendi 2020", si platformë bashkëbisedimi në mes të përfaqësuesve politikë dhe shoqërisë civile për ta rritur transparencën, llogaridhëni dhe efikasitetin e institucionit të Kuvendit.

# Shqipëria-Kosova ndërmjet Lindjes e Perëndimit



Ismet HAJRULLAHU

Serbia është natyrshëm jashtë BE-së, për vetë faktin që ajo është zonë e pranuar edhe nga vetë serbët, si zonë e interesit rus. Deri këtu në rregull. Po Shqipëria dhe Kosova përsë do të ngeleshin jashtë BE-së kur historikisht Shqipëria është parë nga Evropa si një digë për të përballur ekspansionin ruso-turk në Evropë? Atëherë, lind pyetja, cila është arsyja që BE-ja nuk ka interes për Shqipërinë dhe shqiptarët të jenë pjesë e saj? Kjo është një pyetje që ngërthen brenda vetes shumë pikëpyetje! Por në këtë rast dua të ngreh vetëm një paralele dhe të përqendrohem në një fakt të vetëm e shumë domethënës: Kushtetua. Jo çdo veprim i politikanëve është i nevojshëm të jetë i dukshëm ashtu që populli të arrijë të kuptojë se ku është qëllimi dhe caku final. Gjithsesi, pavarësisht prej qëllimeve të politikanëve, e sidomos kur ato nuk janë në interesin më të mirë të popullit, qytetarët kanë në dispozicion Kushtetutën e vendit, përmes së cilës duhet t'ju kujtojnë se ku qëndrojnë limitet, përtej të cilave nuk mund të kalojë askush, e sidomos pa vullnetin e shprehur të sovranit.

Nëse juristët Kushtetutën do ta quanin si aktin më të lartë të një shteti, disa nga ne e kemi më të lehtë ta përkufizojmë si kornizën e vlerave themelore, të cilën përfaqësuesit e popullit kanë vendosur ta jetësojnë duke kërkuar respektim të saj, në kuadër të të gjitha degëve të pushtetit. E kur jemi te vlerat, si Shqipëria, ashtu edhe Kosova, janë dy shtete të cilat shquhen për bashkëjetesën e besimeve të ndryshme fetare. Por, pavarësisht kësaj, kushtetutat e këtyre vendeve në dispozitat e tyre themelore kanë përcaktuar që janë shtete laike dhe neutrale në çështje të besimeve fetare. Duke qenë de juro e tillë, situata faktike duket të jetë pak më ndryshe. Kur jemi te laiciteti, ndoshta në mendim të parë mendohet të jetë çështje formale e që nuk kërkon shumë debat, mirëpo në një shikim të dytë e të tretë del të jetë jetike dhe përcaktuese për të ardhmen e Shqipërisë dhe Kosovës, e sidomos nëse flasim për të ardhmen e tyre evropiane. Në anën tjetër, rezultatet e studimit të "European Stability Initiative" (një think tank evropian), tregojnë se për sa i përket anëtarësimit në BE, Shqipërinë dhe Kosovën, bashkë me gjithë Ballkanin perëndimor, mund t'i presë fati i Turqisë. Sa për të rikujuar, Turqia pati aplikuar që në vitin 1987, për t'u anëtarësuar në BE. Por janë bërë mbi tre dekada e ajo mbetet ende jashtë! Për më shumë, që nga zhvillimet e viteve të fundit të regjimit autoritar të instaluar në Turqi,

çështja e anëtarësimit të saj në BE as nuk është më pjesë e agjendës së Parlamentit Evropian. Por regjimi autoritar nuk është e vëtmja arsy e rezistencës së Evropës ndaj Turqisë. Mos të harrojmë se edhe Turqia është përcaktuar si shtet laik (në letër), ndërkohë që veprimet dhe qëllimet shpërfaqin një tendencë apo vullnet të politikës turke, të shndërrimit të shtetit turk në një shtet islamik. Sa për ilustrim, rikthimi i dënimit me vdekje si çështje në kuadër të diskurrit të brendshëm politik sinjalizon pikërisht përfshirje të koncepteve islame dhe shmangje flagrante të respektimit të të drejtave themelore të njeriut. Por e gjithë kjo nuk erdhi brenda një dit!

Gjithsesi, nisur nga interesat, fillimi i gjeopolitike e më pas edhe ato politike, mospranimi i Turqisë "islamike" në BE është kompensuar duke i dhënë asaj ndikim ekonomik dhe politik në Ballkanin Perëndimor, e sidomos një ndikim absolut në Shqipëri e Kosovë. Turqia tashmë ka privatizuar, ka marrë në koncesion apo ndërtuar sektorët kryesorë infrastrukturore të Kosovës: rrjetin shpërndarës të energjisë (KEDS), transportin ajror (Aeroportin...) dhe ka ndërtuar autoudhët e Kosovës dhe të Shqipërisë si dhe veprimi i fundit i Ministrit të Jashtëm të Shqipërisë, duke i quajtur shtetasit turq "vëllezër", janë indikacione të mjaftueshme për të kuptuar se sa të përhumbur e të dominuar nga Turqia jemi. Të gjitha këto nuk kalojnë pa u

vënë re! Se Perëndimi i sheh Kosovën dhe Shqipërinë si vende turkofile dhe de facto islamike, flet edhe një fakt tjetër, i cili më pak vëmendje do të duhej të ishte mjaft i dukshëm dhe shqetësues. Çdo vit, në festat e fesë islam, shumë personalitetë evropiane, në kundërshtim me kushtetutat tona, nuk harrojnë që të na urojnë nëpërmjet urimeve që u adresohen personalitetëve të larta institucionale dhe politike të të dyja shteteve shqiptare. Si shtete laike dhe me popullsi me besime të ndryshme të cilat bashkëjetojnë në një harmoni të jashtëzakonshme, kjo shpërfaq edhe një herë vlerat e një qytetërimi të lashtë të shqiptarëve. Po kërret institucionalë, si andej dhe këtej kufirit, a janë të vetëdijshëm për mesazhin sublim të këtyre urimeve? Unë them që jo!

Përderisa personalitetet e larta politike të Kosovës dhe Shqipërisë, në kundërshtim me kushtetutat tona, pranojnë urime të tilla, fillimi i shtetet tona janë islamike, fyejnë qytetarët shqiptarë të cilët iu përkasin religjioneve të tjera duke i vendosur ata indirekt në marginat e shoqërisë, si dhe duke stimuluar urrejtjen ndërfetare, shkelin në mënyrë flagrante vlerat themelore të përcaktuara me aktin më të lartë juridik të dy shteteve, si dhe janë në kundërshtim me vullnetin e plotë të qytetarëve. Ngashëm, e që po prapë bazohet në të njëjtën logikë, anëtarësimet në organizata me bazë fetare, siç ishte anëtarësimi i Shqipërisë në

Koherencën Islamike (Organizata Islamike për Bashkëpunim), vetëm sa e përforcon qëllimin e heshtur të kësaj klase politike, i cili është ta identifikojë Shqipërinë, e si rrjedhojë të gjithë popullin shqiptar, përpara BE-së dhe botës, si shtet e popull islamik. Kur dihet botërisht se populli shqiptar në krye me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun mbrojtën si qytetërimin shqiptar, ashtu edhe atë evropian, nga ndikimi dhe pushtimi osman, e nëse personalitetet tona politike, kanë ndarë mendjen të tentojnë ta tjetërsojnë përcaktimin e popullit tonë ndër shekuj, atëherë do të duhet ta mbajnë të vetmuar gjithë peshën e fajit dhe natyrisht do të klasifikoheshin si degjenerues të aspiratave kombëtare të shqiptarëve! Mirëpo, historinë nuk mund dhe nuk duhet të guxojnë ta tjetërsojnë individë, që për interesat të ngushta personale, ekonomike e politike, shpërfillin mundin, idealet dhe interesat e një kombi të tërë, i cili për shekuj me radhë i ka ndërtuar e mbrojtur pa kushte. Prandaj, e ardhmja e shqiptarëve nuk guxon të zhvendoset në lindje. Ajo gjithnjë ka qenë e duhet të mbetet në Perëndim dhe me Perëndimin! Ndërsa Perëndimit i mbetet t'i korrigojë gabimet e veta në raport me shqiptarët, duke zhbllokuar procesin e integrimit të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe duke përmbyllur sagën shekullore të pushtimeve ushtarake, ekonomike e kulturore të shqiptarëve.

## Kosova dhe Shqipëria shkëmbëjnë përvojat në trajtimin e të burgosurve

**PRISHTINË, 31 JANAR (ER)** - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, ka pritur në takim zëvendësdrejtorin e përgjithshëm të Burgjeve të Republikës së Shqipërisë, Femi Sufaj, me të cilin kanë diskutuar rreth punëve dhe sfidave që ballafaqohen të dyja institucionet.

Gjatë takimit, drejtori Thaçi dha zëvendësdrejtori Sufaj kanë shkëmbyer përvojat e deritanishme, me theks të veçantë të ShKK-së mbi shumë fusha, si atë të trajtimit të burgosurve të dënuar për vepra penale terroriste, koordinimit dhe shërbimit të kontrollit të brendshëm, avancimit të njësive ekonomike, trajnimit të stafit etj.

Ndërsa zëvendësdrejtori Sufaj e ka përgëzuar Thaçin për punën dhe të arriturat e deritanishme të ShKK-së, në veçanti përvojat e avancimin në arenat ndërkombëtare, si anëtarësimin e Thaçit në Shoqatën e Burgjeve të Teksasit dhe të ShKK-së në ICPA.

Drejtori i SHKK-së, Thaçi dha zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Burgjeve të Republikës së Shqipërisë, Sufaj, gjatë këtij takimi janë pajtuar për ta vazhduar bashkëpunimin mes këtyre dy institucioneve duke shprehur gatishmërinë përkëmbimin e praktikave sa më të mira në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në çështjet të cilat janë në interes reciprok, e që lidhen me të burgosurit.



# Në Kosovë u regjistruan 2 566 ndërmarrje

Në tremujorin e katërt të vitit 2019 (TM4 2019) në Kosovë janë regjistruar 2 566 ndërmarrje, kurse krasuar me tremujorin paraprak (TM3 2019) ka ngritje për 7.9 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në tremujorin e katërt të vitit 2019 (TM4 2019) gjithsej janë regjistruar 2 566 ndërmarrje. “Në TM4 2019, krasuar me tremujorin paraprak (TM3 2019), kemi ngritje për 7.9 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara, ndërsa krasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2018), ka rritje për 6.9 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara”, është thënë në raportin e ASK-së, duke shtuar se aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregti

me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 602 (23.46 për qind), prodhim me 497 (19.37 për qind), akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 265 (10.33 për qind), aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 232 (9.04 për qind), ndërtimtari me 221 (8.61 për qind) etj. “Në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsej 2 486 ndërmarrje të regjistruara në këtë tremujor (96.9 për qind), me 5 deri 9 të punësuar janë 53 sosh (2.1 për qind), 10 deri në 19 të punësuar 18 (0.7 për qind), 20 deri 249 të punësuar me 9 (0.4 për qind) dhe në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar nuk



kemi asnjë ndërmarrje të regjistruar gjatë këtij tremujori”, thuhet në raport. Sipas ASK-së, sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave

ashtu si në çdo tremujor mbizotëron Komuna e Prishtinës me 831 ndërmarrje të regjistruara (32.4 për qind), Prizreni me 209 (8.1 për qind), Ferizaj me 169 (6.6 për qind), Gjilani me 132 (5.1 për

qind), Podujeva me 119 (4.6 për qind) dhe Peja me 103 (4.0 për qind), ndërsa komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor.

## Bizneset diskutojnë për përfitimet nga zhvillimi i tregut të kapitalit

**PRISHTINË, 31 JANAR (ER)** - Zhvillimi i një tregu sekondar të rregulluar të kapitalit, i cili do të mundëson një financim të decentralizuar për bizneset si dhe do të stimulonte konkurrencë në aspektin e financimit, do të ishte shumë i mirëseardhur për ekonominë e vendit. Kjo u konkludua në një tryezë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë në lidhje me iniciativën e një tregu të kapitalit në vend.

Ekonomisti Agim Demukaj e definoi tregun e kapitalit si treg në të cilin takohet oferta me kërkësën. Ai u shpreh se një treg i tillë, i njohur ndryshe edhe si treg finanziar, edhe pse ekziston në njëfarë mënyre në Kosovë, nuk është i rregulluar, dhe se është pikëpyetje se cili institucion do të ishte adekuat për rregullimin e tij. Sipas



Demukajt, interesimi nga aktorë të ndryshëm për zhvillimin e tregut të kapitalit në Kosovë është i pranishëm, por mungesa e legjislacionit bazë, mekanizmave, instrumenteve, si dhe rreziku i funksionimit paraqesin pengesa. Rinor Gjonbalaj, drejtor

ekzekutiv në MDA, foli për nevojën e krijimit të një ekosistemi në të cilin banka është suplementare, pra një aktore me shumë rëndësi, por jo e vëmja palë në të cilën mundësohet qasja në financa. Ai prezantoi idenë e tregut të kapitalit si një kornizë e re që do

të nxiste konkurrencë në sektorin e financimit si dhe do t'u mundësonte bizneseve në veçanti, dhe shoqërisë në përgjithësi, të kenë burime alternative të financimit. Ai tha se në krasim me vendet e tjera, bizneset në Kosovë mbeten të varura nga bankat për financim,

gjersa ky treg do të zbullokonte më shumë investime për të gjitha kompanitë si dhe do të tjerhiqë më shumë investime të huaja direkte.

Ramis Ahmetaj, konsulent i biznesit, theksoi se duhet të krijohet një agjencji gjithëpërfshirëse për rregullimin e tregut të kapitalit, ngaçë për të ardhur deri te një sistem i tillë duhen zhvilluar shumë aspekte legislative të cilat qartësojnë veprimtari përkatëse.

Ahmetaj potencoi se meqë ky treg ekziston në të gjitha vendet e rajonit, nuk është e pamundur që i njëjti të zhvillohet edhe në Kosovë. Sipas tij, nevoja për krijimin e këtij tregu është e menjëherë meqë ky do të mundëson stabilitet të sistemit financiar, duke ofruar një shumëlojshmëri të mjetave të financimit.

## Publikohet Studimi Zhvillimor “Zhvillimi biznesor i Minierës së Goleshit”

**PRISHTINË, 31 DHJETOR (ER)** - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka njoftuar për publikimin e projektit “Business Development of the Goleshi Mine” (Zhvillimi biznesor i Minierës së Goleshit). Projekt është financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) pas bashkëpunimit shumëveçar mes AKP-së dhe institucioneve gjermane, përmes Njësisë së Trepçës në AKP. Punimet studimore të projektit

janë realizuar nga ekspertë të kompanive “Inros Lackner” dhe “EC Terra”, kurse kanë filluar në tetor 2018 dhe kanë përfunduar në dhjetor 2019. Duke trajtuar MIM Goleshin si aset strategjik, Agjencia ka kërkuar studim për konfirmim të opinionit nëse kjo ish-ndërmarrje shoqërore ka potencial zhvillimor me mundësi të krijimit të vendeve të punës dhe të hyrave, studim ky nga ekspertë me përvojë dhe kredibilitet ndërkombëtar, i cili do t'i shqyrtojë mundësitë për një projekt profitabil, social dhe

mjidisor.

Pas përfundimit të projektit, Agjencia ka përfituar të dhëna të reja përmundësítë e shtimit të vlerës të MIM Goleshit dhe vlerëson se këto të dhëna duhet t'i bëjë të qasshme edhe për publikun. Për këtë qëllim ka vendosur ta publikojë versionin original të këtij studimi në uebfaqen e AKP-së, në mënyrë që t'i shpalosë mundësitë si për institucionet vendore, ashtu edhe për investitorët e interesuar, duke prezantuar mundësitë që ofron Goleshit dhe



duke veçuar mundësinë relativisht të shpejtë përkthim të investimeve. Në nëntor 2019 Agjencia ka prezantuar MIM Goleshin në

Konferencën “Mines & Money” në Londër dhe me këtë rast interes i investitorëve për Golesh ka qenë i konsiderueshëm.

# **DASHURIA SADO, MAZOKISTE MIDIS ROMEOS (LV-së) DHE XHULJETËS (LDK-së) NË KOSOVË!**



## **Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA**

**Kush e bën hapin e parë, del të bëhet kryetar:** Dashuria midis LV-së dhe LDK-së tashmë është antologjike, me shumë tundime dhe me shumë kthesa të paparashikuara duke i vënë në siklet analistët që pretendojnë se janë Nostradamus apo baba-Vanga në parashikimin e zhvillimeve globale dhe në këtë kontekst edhe zhvillimeve në Kosovë, si pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ndikuese, mos ta them përcaktuese në zhvillimet e përmasave planetare. Dashuria midis Romeos (LV-së) dhe Xhuljetës (LDK-së) është shumë interesante, sfiduese, e pabesueshme dhe patologjike. Dashuri që i shkakton vuajtje njëra-tjetrës, dashuri me elemente të sadizmit dhe mazokizmit ku, duke i shkaktuar vuajtje partnerit, këtë kënaqësi e shndëroni në vuajtje ndaj vetes. Kjo dashuri, në mungesë të marrëveshjes së nënshkruar përmartesë (koalicion), është shndërruar në bashkëjetës të dy partnerëve që herë e kalojnë përbukuri, ndërsa herën tjetër vetëm sa nuk i nxjerrin sytë njëri-tjetrit! Ky rast, nëse trajtohet sipas legjislacionit në fuqi, duhet të

cilësohet si dhunë në familje përkatësish si dhunë në familje, e përsëritur dhe e stërpërsëritur! Dhunë që Romeo (IV-së) po ia bën Xhuljetës (LDK-së)! Po pse Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit nuk po marrin masa ndaj kësaj dukurie, aq të ndjeshme sa edhe shqetësuese për të gjithë në Kosovë, me të drejtë mund të pyesni, lexues të nderuar? Arsyja është kjo:

1. Pasi rasti po fillon të hetohet, Xhuljeta apo (LDK-së) po tërhiqet nga denoncimi publik duke u betuar publikisht në dashurinë dhe besnikërinë ndaj dhunuesit, Romeos (LV-së). Në mungesë të vullnetit dhe gatishmërisë për bashkëpunim me organet e ndjekjes dhe të hetuesisë nuk mund të ketë aktakuzë apo edhe një vendim të gjykates për dhunë

2. Romeo (LV-ja) i bëri ofertë Xhuljetës (LDK-së) për martesë para zgjedhjeve të 6 tetorit 2019, por Xhuljeta (LDK-ja) e konsideroi si dhunë duke menduar se, si beqare (fituese e zgjedhjeve do të jetë në pozitë të zgjedhë kë të dojë, pa qenë e detyruar t'i dorëzohet të vetmit kandidat, Romeos (LV-së). Kur nuk doli kështu, Xhuljeta (LDK-ja) premtoi se pas

zgjedhjeve do të lidhej me Romeon (LV-së) duke u betuar publikisht se, nëse nuk lidhet me Romeon (LV-së), nuk do të martohet me askënd tjetër, edhe me çmimin të mbetet beqare (në opozitë).

**3. Kur Romeo (LV-ja), në vend të Xhuljetës (LDK-së) para altarit (Kuvendit të Kosovës), siç ishte betimi dhe besimi, e sollën përsëri Romulin (LV-në), babai i Xhuljetës (edhe i LDK-së) e cilësoi si dhunë dhe tradhti. Në vend se ta kallëzojë penalisht të organet e rendit, përsëri u deklarua për dashuri dhe besnikëri ndaj dhunuesit (LV-së) nëse Romeo (LV-ja) në vitin 2021 do të martohej me Xhuljetën (LDK-në) dhe jo me Shimin.**

**4.** Në kohën kur Romeo (LV-ja) i caktoi pesë (5) shkues (për qeverinë e ardhshme), Xhuljeta (LDK-ja) u ndje e dhunuar sepse ishte kundër bërjes publike të emrave të shkuesve, pa pëlqimin e saj. Mirëpo, edhe pas kësaj u betua në dashuri dhe besnikëri ndaj dhunuesit (LV-së). Dhe,

**5.** Pasi Romeo (LV-ja) erdhi në përfundim se është koha për kurorëzim të dashurisë dhe urrejtjes me Xhuljetën (LDK-në), duke e caktuar datën e 3 shkurtit 2020, pa lejen e Xhuljetës (LDK-së), kjo e fundit përsëri po ndihet e dhunuar sepse nuk po pytet fare për fatin e saj, si pjesë e fatit të përbashkët mirëpo, përsëri po betohet publikisht se është në dashuri dhe do t'i qëndrojë besnik dhunuesit apo Romeos (LV-së), deri në çastet e fundit!

Me këtë lojë fjalësh vetëm desha ta theksoj faktin se që nga fillimi i aventurës politiko-erotike midis LV-së dhe LDK-së, LV-ja gjithmonë e ka bërë hapin e parë, pa u konsultuar fare me LDK-në pas së cilës LDK-ja ka reaguar se ndihej e tradhtuar, e prerë në besë dhe aspak e trajtuar si partnere për bashkëqeverisje. Mirëpo, që është mjaft e çuditshme dhe, madje e pabesueshme, pas çdo ngulitjeje që përjetonte nga LV-ja, LDK-ja përsëri betohej se është besnikë dhe e përcaktuar për një dashuri qeverisëse me LV-në duke përjashtuar çdo lidhje me partnerë të tjerë, deri në ofertën tictar.

Kohët e fundit LV-ja, në veçanti Ajatollahu politik i saj, Albin Kurti, po përqeshen shumë për "gafat" që po i bëjnë duke përsëritur në mënyrë të paskrupullt veprimet për të cilat pamëshirshëm shijetonte dhe pushkatonte opozitën e sotme në kohën kur kjo

opozitë ishte në pushtet. Po mendojnë se Albin Kurti e ka humbur rrugën në oborr. E kanë shumë gabim, do të binden. Albin Kurti asnjëherë nuk e ndërmerr ndonjë veprim apo vendim pa e tjerr hollë dhe hollë. Edhe me LDK-në po e luan të njëjtën lojë duke e lodhur pak para çakut

Albini është maratonist, përshtigje të gjata, kurse këta të LDK-së janë sprinterë të cilët kërkojnë shfigje sa më të shkurtra për të mbërritur deri te caku (posti apo pushteti). Për këtë nuk e kanë problem nëse edhe rrugën e shkurtër e bëjnë edhe më të shkurtër duke bërë hile (kushtëzime). Mendoj se ky koalicion do të bëhet, por se nuk jam aspak i sigurt se sa do të jetë i dobishëm. Diqka që bëhet apo krijohet me dhunë, me imponime apo me kushtëzime, nuk mund të ketë, as ecje normale e as njerfundim normal!

Albini nuk e ka problem të shkojë në zgjedhje sepse në zgjedhjet eventuale e që nuk shoh asnjë arsyе se duhet të mbahen, votuesit do t'i tërheqë, jo më me bashkimin kombëtar, por nga këndvështrimi i një viktime që, duke u viktinizuar (bërë koalicion me LDK-në), me të vetmin qëllim ta shpëtojë Kosovën, pikërisht nga këta po pengohet duke e futur në këto radhë edhe LDK-në!

Edhe në planin psikologjik Albinë ka krijuar epërsi shumë të madhe përballë LDK-së duke dërguar vazhdimit shqiptar i ofertës për të cilat ishte i sigurt se do të refuzohen sikur që çdo anëtar i LV-së, qoftë dikush nga Kominterna e LV-së e deri te vendvendosësit hibridë e që u anëtarësuan para disa muajve e deri te "luftëtarët" e orëve të para të LV-së, pa asnjë përjashtim, po deklarohen se janë dhe se do të ketë koalicion qeverisës me LDK-në pasi nuk ka tjetër alternativë!

Në anën tjetër, LDK-ja, përvëç paraqitjes në rolin e viktimit dhe lotëve të Vjosës dhe të Fatmirit, thuaja në të gjitha paraqitjet e vënë në dyshim këtë koalicion! Të gjithë e kujtojmë me mall dhe pikëllim fundin tragjik të Romeos dhe Xhuljetës në Verona të Italisë që e pinë një helm për ta kurorëzuar koalicionin e përjetshëm dhe amshimin. Tash, për hir të kësaj sakrfifice për dashurinë dhe në emër të dashurisë, e kemi një ilaq të quajtur Veronal, jo që përdoret si helm, por si qetësues.

Cili do të jetë fati politik i të dashuruarve tanë të urryer mes vete, Romeos (LV-së) dhe Xhuljetës (LDK-së)? Besoj se ata duhet të përdorin Veronalin për t'u qetësuar në mënyrë që ta kurorëzojnë dashurinë dhe e tyre me një koalicion për bashkëqeverisje, ndryshe vdekjen (politike) e kanë të pashmangshme.

Lëreni interesin e Kosovës dhe të qytetarëve të saj, bëjeni këtë për festën e Shën Valentinit dhe shën Grenellit! Nuk ka rrugë tjetër!

**Hashimi i Madhërishëm:** Hashim Thaçi-Shimi sot është njëriu më sakrifikues për shtetin e Kosovës. E ka lënë krejtësisht anash interesin personal për bir të

Kosovës. Po rrezikon edhe sigurinë personale duke u angazhuar për Kosovën. Kur prapanica nuk po i lëviz nga bussinesclass e avionëve duke shkuar në çdo vend të botës, pas vijës së Grenellit për Beograd e ka edhe një mundësi më shumë. Nuk ka të tjerë sa i përket sakrificës për Kosovën përveçse jo krejtësisht si ai, por afersisht të njëjtën sakrificë e bën Behgjet Pacolli. Dhe këtu përfundon tregimi. Hashimi tërë kohën është angazhuar për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës, të integruar në NATO, BE dhe në Shoqatën e Gjyqtarëve të Gjylekarit. Sot e ka bërë një hap të admirueshëm dhe të madhërishëm në planin e integrimeve evropiane duke përqafuar vlerat më të mira në planin e respektimit të të drejtave të njeriut; e formoi Këshillin Konsultativ të Komunitetit LGBTIQ. Urimin e parë e mori nga Richard Grenell që po nxjerrë marrëveshje me Serbinë, pa ditur fare për to, pa na pyetur fare, deri në marrëveshjen përfundimtare me Serbinë pér të cilën, gjithashtu, nuk do të pyetemi fare! Nëse Hashimi, deri më tanë, na e ka bërë atë punë, e sigurisht se na e ka bërë prej se u bë bashkë me Vuçiqin dhe Ramën, pa e konsultuar askënd, tash do të na bëjë me kompetencë. E ka Këshillin Konsultativ!

**Gati të ikë për lesh Bonelli:** Trashëgimia vepruese, dëmtuese dhe shkatërruese për Kosovën e Frederika Mogerinit, i shpërfaqur si Bonelli, ishte në vizitë dhe u takua me të gjithë, duke përsëritur në mënyrë bajate frazat e mbllaçitura nga Moderini dhe burokratët e Brukselit se: "Nuk mund t'jua jap një datë për liberalizim të vizave e as se do t'ju njojin të gjitha shtetet e BE-së, por se ju duhet t'i vazhdoni bisedimet me Serbinë për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare për normalizim". Borrelli as që e vë në gojë pavarësinë e Kosovës, ndërkaq që shumica e politikanëve të Kosovës rrinë cuc para tij! Kësaj radhe ia ftohën vetëm Kadri Veseli i PDK-së, Ramush Haradinaj i AAK-së dhe Dardan Gashi i Listës Rugova. Nuk ia vunë fare në pullë. Ka informacione se refuzimi për takim ka krijuar stres për Borellin dhe, për këtë arsy, me të mbërritur në Aeroportin në Bruksel, është trajtuar nga Emergjencia e Qytetit dhe vetëm fati e shpëtoi, të ikë për lesh siç thonë miqtë shqiptarë nga Shqipëria. Po vazhdojmë të bëjmë sherre jo vetëm na rrashin vendor, por edhe në atë ndërkombëtar. Pas një infuzioni qetësues, si trajtim pas stresit të përjetuar, Borrell Mogerinit iu premtua vizita protokollare në selitë e PDK-së AAK-së, dhe tek

Uka, Dardi dhe Çija!  
**Ah Natali, Natali... Apostolova:**  
Sharl Aznavur (ian), bashkëpatriot  
i Kim Kardashianit, shansonjer i  
njohur francez, i pati kushtuar një  
shansonë Natalisë

I papërsëritshëm është zëri i Sharlit drejtuar Natalisë. Edhe Fazliu, sa ishte futbollist i Llapit, atraktiv, i pashëm dhe sharmant, ndonëse në moshë më të re, në atë kohë e pati zënë Natalinë, një e huaj, mund të ketë qenë edhe bullgare e që punonte në Podujevë atëherë e që ishte femër e fortë. Të gjithë adoleshentët e Podujevës atëherë e që i hanim bananet pa qëruar fare e kishim idol Fazliun të cilin e quanim Zhan Pol Belmondo apo Alen Dellon. Edhe gjatë studimeve e pata takuar një Natali në Sarajevë, e bukur si kjo Apostolova e cila më hodhi në gjunjë. Harrova përkatësinë kombëtare, Skënderbeun, Isë Boletinin, Hasan Prishtinën dhe madje edhe Ismajl Qemalin, që do të thotë se e mohova edhe aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë duke ia shkruar një letër, jo dashurie, por besnikërie, sikur këto që po ia dërgon LDK-së, IV-së, ia dërgova me postë më të shpejtë të asaj kohe (përmes njës kolegeje të studimeve të cilës ia pagova 6 lugë akullore nënë émbëltoren "Egipat" në Bashqarshë të Sarajevës dhe nuk shkoi shumë kohë dhe e mora përgjigjen; "da si seljak, znala sam i nisamsumnjalaida si tolilikovellikiseljak, nisamverovalla..., trazhisebidevojku na Romaniji, nekuçobanicu koja çuvaovce ..." (Se je katundare kam ditur dhe nuk kam dyshuar fare, por se je katundar aq i madh nuk kam besuar... gjëji vetes një vajzë në malet e Romanisë, ndonjë bareshë që ruan dele...").

Nuk e di si e përjetove nëpërkëmbjen e krenarisë, mbeta me trauma. Tash, thuaja 40 e sa vjet pas asaj tragedie që e pësova në Sarajevë, një Natali, tash në Prishtinë ma ka hidhëruar shumë njërin ndër miqtë më të mirë që i kam, Behgjet Pacollin (mikun më të madh, pa asnjë dyshim e kam Hashim Thaçin). Moti nuk e kam parë Begjën më me nerva, doli nga vetja e që njihet për një stabilitet emocional dhe qetësi mendore që e ka për shkak të një pozitiviteti skajshmërisht negativ që e ka. Dhe i dërgoi një letër Natalya Apostolovës, në gjuhën bullgare. Unë Natalisë "sime" i pata dërguan letër në gjuhën serbo-kroate, si gjuhë zyrtare dhe amtare e shumë patriotëve të sotëm kosovarë sepse, po ta dërgoja në gjuhën shqipe, do të ishte shumë problem për Natalinë. Miku im Behgjet Pacolli i dërgoi letër Natalya Apostolovës në gjuhën bullgare se po t'i dërgonte letër në gjuhën shqipe, do të ishte shumë problem për Behgjet Pacollin!

# **Filozofia politiko-strategjike e Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës**

*(Ose rrëfimet e Zahirit, Hakifit dhe Edmondit në vetën e parë njëjës)*



# Akademik prof. dr. Hakif BAJRAMI

Në bazë të argumenteve arkivore mund të thuhet se Zahir Pajaziti, Hakif Zejnnullahu dhe Edmond Hoxha kishin planifikuar lufë speciale, e cila ndryshe mund të quhet neoluftë. Këtë strategji çlirimtare ata e sajuan si nxënës të Akademisë "Skënderbej" në Tiranë. Këta heronj të kombit do ta luftojnë paleoluftën në anën tjetër, deri në atë shkallë saqë nuk dihet në "artin" e tyre të luftës, e kishin përparësi shporrja e okupatorit, apo zakonet e vjetra të paleoluftës: ku vriten gra, fëmijë, pleq e plaka, dhunohen femra e meshkuj, digjen shtëpi dhe rrënohen përmendore të të gjitha llojeve. E kundërta, filozofia e shkollës së Zahirit, Edmondit dhe Hakifit si luftë speciale, si neoluftë do të thotë se nuk guxonte të përlyhet e të identifikohet lufta e drejtë me luftën koloniale. Këtu peshon esenca e luftës sonë çlirimtare të cilës iu bashkua pas shumë peripecish tërë bota e civilizuar. Ishte kjo luftë risi globale, sepse Zahiri është i pari ndër të parët, që po e mësonte këtë shkollë e që mbante emër të kryeheroit që ishte mit popullor e që duhej çmitizuar me veprimitari të dëlirë kombëtare, deri në realizëm.

Për këtë mësim të tyre në atë akademi prestigjioze ushtarakë shqiptare-Skënderbej, çarqet intelektuale majtiste në Kosovë me kohë e dinin në detale se cili është misioni dhe si nxirret profesioni prej kësaj shkolle. Dhe kohë pas kohe në kontaktet e rralla se si të reshtohemi në luftën politike dhe ushtarakë për çlirimin e Kosovës, që të tre ishin të një aksione, se pa gjak nuk ka liri dhe çlirim të Shqipërisë kontinentale.

Në takimin e parë më 10 maj 1995 mësova se Zahiri dhe Hakifi e kishin të njëjtin koncept të luftës. Por, nuk kisha asnjë informatë se ata ishin plot dituri strategje dhe teori sinkronizuese, se si duhet zhvilluar lufta speciale, për çlirimin e Kosovës. E ata kishin shkuar shumë larg në përvetësimin e asaj filozofie të Gjergj Kastriotit. Luftën speciale aty kah mbarimi i vitit 1996 këta heronj e kishin pjkur në doktrinë

në leksionet që i merrnin kohë pas kohe në Akademinë "Skënderbej" në Tiranë, plus me literaturën me të cilën furnizoheshin. Një mësim i pashtmangshëm i tyre ishte se: "Nëse e mëson historinë e familjes patriotike shqiptare, nëse mbështetësh në patriotizmin e rilindësve dhe patriotëve që organizuan dhe bërën luftë të drejtë, ke investuar në ardhmëri, sepse mëson dhe nxjerr aksiona për lavdinë e saj". Në vijim

nga këta heronj kisha mësuar se: "Shqiptarët nëpër shekuj, gjuha e përbashkët nuk i ka lejuar të përcahlen në trafe e krahina të hasmëruara, siç ka ngjarë te shumë popuj. Tash shqiptarët duhet t'i bashkojë një faktor determinues që do të thotë, se duhet të shprehën përmes gjuhës shqipe, se janë një zë i dëlirë etnik. E këtë faktor determinues që e forcon kombin kudo që jeton, është kryefjala e luftës së drejtë prej së cilës do të dalim fitimtarë. Të dëmtuar po, dhe në shikim të parë me plot plagë në turp. Por, lufta jonë e drejtë nuk do të jetë as frontale e as guerile, por ka lindur nga nevoja dhe rrëthanat që të shpërthej në një luftë speciale, në të cilën okupatori, do të krijojë bindje se e ka armik: çdo rrugë, çdo urë, çdo kthesë, çdo shtëpi, çdo lagje, çdo fushë bereqeti, çdo pyll e mal. Pra, armiku nuk guxon të ndihet askund i lirë. Pesha e luftës sonë të drejtë speciale duhet të ndihet kudo, madje edhe në zyrat më të sofistikuar të armikut duhet të shkelë pasiguria, se vdekja e dhunuesit, e sistemit të tij gjakatar është me afat dhe ajo bombë është me sahat, që regjin e okupatorit e përcjellë vdekja kurdo, si hija e vet, sepse sahati është në duartona. E ne kur duam e kurdisim".

Pra luftës sonë të drejtë, mëson filozofia komando e Zahirit, duhet t'i maturohet e aprovuar nga populli, i cili në fazën e njomë të luftës, do të ngritë dilema, por pjkuria do të vijë ngadalë, por e sigurt si nevojshmëri e pashmangshme, sepse është domosdoshmëri, sepse nuk mund të jemi më thes i vrimave në Evropën e progresit dhe diturisë kolektive, sepse ne duhet të bëhem i pjesë e saj pasi që kemi qenë dikur bërthamë kryesore e asaj tërësie plotë plagë të pashëruara E këtë progres dhe dituri kolektive që e ka siguruar Evropa në shekullin XX, nuk ka shans që ta çlrojmë e të bëhet pronë popullore me luftën tonë të drejtë pa famën e Kastriotit, pa sakrifica dhe pa përkushtim, sepse pa asnjë dilemë krisma e armëve tonë, duhet ta shënojë fundin e shpirtit të përgjakur me trupin tonë, i cili do të grumbullojë energji rimore, posa t'i shënojmë viktimat e para të dhunuesve që rrabin popullin në pikë të ditës, dje e sot nëpër pazare, trena, autobusë, shtëpi dhe ara, punishte individuale e kolektive, ku rrahet një për t'i frikësuar të gjithë. Këtë realitet e mësonte kryereroi i UÇK-së, duhet ta ndryshojmë dhe do të ndryshojë mos me dëshirë, atëherë me grykën e pushkës, që nuk përlhyet në njerëz të nefasikës së orës së mëtejshme.

Vrasja e aspirantëve të dhunës  
shtetërore, detyrë speciale për tu  
liruar prej tyre

Së pari duhet të shënohet sistemimi i tyre si dhunues se a do të likuidohen dhunuesit dhe hafijet e okupatorit, sipas peshës-gradave, apo rrëthanave. Për këtë specialitet duhet të vendosë çeta speciale, me komandë dhe disiplinë rigorozë ushtarakë të tipit

komando, pa e lakuar kurrë famën e Kastriotit. Lufta jonë speciale, mësonin Zahiri, Hakifi dhe Edmondi e ka hapësirën gjeografike, gjërësinë dhe gjatësinë e limituar. E para dhe dyta (hapësira dhe lartësia për shkak të armatimit të kufizuar janë në pozitë delikate, kurdoherë sepse kuadrot mungojnë). Ndërsa gjatësia e luftës as nuk fillon e as nuk mbaron me neve. Kjo luftë speciale, duhet zhvillohet në shkallë permanente dhe pa pushim në intensitet. Aty ku bie unë, e vazhdon ti, aty ku biem të dytë, e vazhdon i treti, aty ku biem të tretë, aty pikërisht ngritën dhjetë kreshnikë të lirisë, dhe kështu deri në pambarim, deri në çlirim sepse më së shumti besojmë në qenien tonë, në përkushtimin tonë të drejtë.

“Supremi ije akcionë trigonometrike ushtarakë, që e fshehë lufta e drejtë, e që nxjerr leksione nga filozofia e historisë skendërbegjiane, koncept ky që kishte gjetur perfeksionim në Tiranë, të mësuar urtësisht nga pedagogët e akademisë, gjithnjë duke e ruajtur famën e emrit. Kur jemi të ky nivel i edukimit ushtarak dhe zbatimi i tij në praktikë, Zahiri sidomos, do të shtrojë pyetjen e mbijetesës së luftës së drejtë. Në pyetjen pse kanë mbijetuar shqiptarët, në luftërat permanente të luftës së pabarabartë (?), do të përgjigjet pa hezitim: “Sepse shqiptarët kurrë nuk kanë pasur problem me vetidentifikimin, pa marrë parasysh se kanë qenë të ndarë në tri fe e janë varrosë në tri palë varre veçmas. Pra shqiptarët kanë jetuar së bashku, por në botën ‘tjetër’ kanë pushuar me tre flamuj. E këta flamuj duhet të unifikojmë në një sikurse alfabetin e dalë nga Kongresi i Manastirit. Në këtë rrafsh çarqet tona respektive, edhe pse janë ndërruar okupatorët e kanë mundur dhe shpesh i kanë shërbyer atij (okupatorit), prapë shqiptari ka mbetur si reprezentues i vetidentifikimit, pranë kroit, pranë burimit, pranë vatrës në të cilin okupatori vijues ka pi ujë, por me droe. Pra është krijuar koncept, se i huaji nuk ka perspektivë, është në kalim në trojet tona. E okupatori është fare mirë i informuar se ai “përfaqëson” okupim, se ai e din se luftën më në fund e ka të humbur. Sot (1996), ata që na përfaqësojnë në politikë, mund t’i kanë nga e dy e tri fytyra polidimensionale. E ne që krijojmë koncept tjetër mbi ndërtimin e lirisë, duhet të lëvizim drejt për ta shpëtuar fytyrën e parë, atë të vërtetët, atë të kombit dhe heroit të tij, se luftën e kemi përnjëmend dhe seriozisht dhe me asnjë çmim nuk guxojmë ta përllyjmë famën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Zahiri, na thonë Hakifi dhe Edmondi, kishte politikë të veprimit, strategji të fitores dhe diplomaci të bindjes së dy veprimeve që lindin dhe vdesin në të njëtin çast, por koha dhe jetë ngadhënjejnë pa pushim. Mu për këtë dhe jo vetëm për këtë, Zahiri thelli

besonte në largimin e okupatorit me luftë të drejtë, sepse kuadrot do t'i dëmtohen, armatimin nuk e ka përparrësi, sepse motivi jonë për liri është armë më e fortë, sikurse vetëtima, dhe është në raport dhjetë me një në favorin tonë e këtë fuqi ia dhuron koha që punon për neve. Por ky njëshi, është i fuqisë shkatërruese sa që çdo pozicion të okupatorit do ta bëjë copë e grim, kudo që frymon. Okupatori, do të mbetet duke i lidhur copat e grimat pas çdo aksioni që ne e kryejmë. E ne, do ta zhvillojmë aksionin vijues, që do të jetë shumëfishtë më trishtues, jo për civilë, jo për njerëz pa faj, por për uniformën dhe efektivat e tmerrit që një ditë duhet të shporrën përgjithmonë. Koha punon për kauzën tonë, do të shpreheshin Hakifi dhe Edmondi. Kurse Zahiri do t'i plotësonë se "kauza e ndrydhë kohën dhe të dyjet okupatorin". Një ditë okupatori me dhunën e vet, do të bërët hi e shpuzë, nga trashësia. E grimcat e asaj shpuze nuk do t'i ndërtojmë ne në mozaik, por do t'i përplasim edhe më tej në humnerën e historisë, sa që nga shkallmimi që do të mësojnë nga arma jonë, nuk do të këndellën ma kurrë. Okupatori ma nuk do të mbetët as flakë, as shpuzë e as hi. Shkurtë e shqip, okupatori do të shporrët në shkretëtirat e veta. Në këtë filozofi, të luftës ne nuk jemi larg ngrohtësisë atdhetare të Avni Rrustemit. Por, nuk mendojmë se çështjen do ta zgjedhë pushimi i një jete, sa do tradhtar i egër të jetë. E kemi fjalën për infeksionin individual dhe kolektiv në radhët tona. Me këtë staf, që do të pretendojë okupatori ta kthej në fis nënshtrees tëre kombin tonë, ne do t'ia shkëpusim rrënjet, dhe shumë shpejtë

gjethet e asaj peme të egër, do të vyshkën deri në turp e trishtim. Prandaj, kjo sëmundje infektive e okupatorit dhe hafijeve e saboterëve, që si fatamorganë do të ketë sukses dy ditë, të tretën nuk do të ketë jetë mbi tokë për te, sepse Republika e Kosovës është diçka më tepër. Republika e Kosovës, do të jetë sepse është ëndërr më e fuqishme për çlirim se çdo termet, që krijon relief të ri mbi tokë.

Zahiri, Hakifi, Edmondi nuk kishin dallime në aksione, sado që po mësosheshin së bashku në shkollën e "barotit të lirisë". Në rastet kur duheshin të vendosin sekondat, e të shënohet historia, mësonin ata, nuk ka pyjetje: cili është i pari, por cili është më i rrufeshëm, më komando dhe më efektiv, sepse pastaj armët tonë nuk do të na e falnin, sepse ne nuk bëjmë gara ndërmjet vete, por ne bëjmë gara mbi efektin e luftës sonë të drejtë dhe sublime çirimitare, ku përfshihet çdo pëllëmbë e tokës robëruar në luftën e drejtë. Nuk ka ma shembuj se kur lufton Drenica, Llapi heshtë e Shala krehët, e Dukagjini e Karadaku bëjnë dasma. Jo të gjithë me një komandë, të gjithë në një front, të gjithë nën një flamur të Kastriotit dhe me komandë të dëllirë shqipe.

## Pse i kemi rrokur armët

Sepse populli ynë nuk është i lirë edhe kur shkon në arë, edhe kur shkon në xhami e kishë, sepse kur shkon në shkollë fëmiu, sepse kur shkon në pazar i zoti i shtëpisë, sepse kur e mbjell arën, sepse kur e korrë bereqetin, sepse kur shkon te miku për vizitë, nuk guxon të ndihet i çiltër, i gjëzuar e i hareshëm, sepse gjithmonë duhet të ndihet i mërzitur, i dëshpëruar dhe pa shpresë, se nesër do të ketë çati e strehë që nuk i pikon. Shkurtë e shqip, njeriu ynë shqiptar duhet, në këtë regjim që do ta shporrim, të mos jetojë si lepuri në therë, gjithmonë me dro. E atë dro do ta kthejmë në këngë hareje dhe barazie për të gjithë, pa urejtje racore, fetare e kombëtare.

Ne i kemi rrokur armët sepse njeriu i jonë, duhet ta nderojë pylltarin, tagërmblehdhësin, mësuesin, kolonistin, e që të gjithë nuk flasin shqip, por Kosova nuk duhet të lejohet që të sllavizohet. E të gjithë të tjerët që nuk flasin sllavisht, janë soj që okupatori ka vendosë t'ua garantojë jetën. E ne atë jetë të tyre do ta shporrim. E ne nuk e garantojmë as okupatorin e as jetën e atyre hafijeve që dhunojnë dhe grabisin pa pushim pronën tonë, historinë tonë. E kundërta, pushka jonë është kundër tërë kësaj errësire kundërmuese shoviniste. Ne nuk mundemi ma të durojmë që çirilica dhe sllavizimi të na e ndalë frysma marrjen kudo dhe kahdo, për mos me lërë të jetojmë si njerëz. Prandaj, luftën tonë, kauzën tonë ngadalë bota e qytetëruar, sidomos bota perëndimore do ta kuptojë se ku pushon rrënja katrore e saj në kohë dhe hapësirë.

## Do ta transformojmë jetën në tërësi

Ne nuk do ta transformojmë lirinë sepse nuk luftojmë për kontra liri. Por, liria e jonë është si ajri. Atë duhet ta konsumojë ai që ka nevojë për të dhe që e meriton dhe e respekton rregullin e ligjit universal, të cilin nuk do të i përshtatnim e as shartojmë, por nuk do të jemi hakmarrëse, racistë dhe ksenofob, e as aristokratë dhe elitistë, sepse nuk do të kemi respekt nga shkolla jonë skendërbegjiane, pra do të grumbullojmë miqësi me popujt dhe qeveritë që e kanë dert shovinizmin dhe iu kanë kthyer ardhmërisë se të gjithë qytetarëve. E ne nuk luftojmë që t'i çlirojmë shqiptarët dhe t'i robërojmë të tjerët. Lufta jonë është e dëlirë dhe mu për këtë do të triumfojë, sepse me neve do tëjenë të gjithë popujt dhe qeveritë që duan dhe ndërtojnë pushtet dhe shtete të barazisë ekonomike dhe qytetare. Kjo përfaktin se para ligjit dhe gjyqit e drejtësisë universale, në këtë rrugë edhe para Zotit dhe zërit të popullit, të gjithë do të jemi të barabartë. Lavdi të gjithë luftëtarëve të UÇK-së, Adem Demaçit dhe Adem Jasharit-legjendarit.

Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (15)

# Shpejtësia e dritës dhe errësirës brenda sferave




**Shkruan: Naim Krasniqi, fizikan**

Ashtu sikur është cekur në botimet (Krasniqi, 2019), se drita dhe errësira nuk lëvizin me shpejtësi konstante, kësaj shpejtësia sferat e trupave qellorë u japin edhe një shpjegim më të qartë. Duke u bazuar në këto të dhëna themi se rrezet e diellit në formë drite shpërndahen brenda sferës së diellit me shpejtësi të ndryshme. Shpejtësia e dritës zvogëlohet në hyrje të sferave të trupave qellorë, ngashëm ndodhë edhe me shpejtësinë e dritës që buron nga dielli dhe vije në drejtim të sferave të fushave vepruese të tokës, sepse fusha antimagnetike e tokës e cila është prezentë në të gjitha sferat e pengon këtë. Madje këto sfera e bëjnë edhe lakimin e dritës varësish nga këndi që bien.

Ne kemi fat që toka si trup qellorë, ka para vetës në drejtim të diellit merkurin dhe Venerën, dy trupa qellorë që nuk posedojnë sferat e fushave ashtu sikur posedon toka, përndryshe po sikur këto planetë të posedonin sfera, në tokë jeta do ishte e pa mundshme, sepse në momentin kur këta trupa me sferat e tyre, të jenë në mes tokës dhe diellit do të kishte rënë ekstreme të temperaturës në tokë.

Një rënie e temperaturës vërehet edhe te planeti i marsit për shkak se sfera e tokës e cila ka një rrreze shumë të madhe kur ndodhet para marsit ndikon në temperaturën e marsit. Por njëkohësisht sferat e fushave e mbrojnë edhe planetin tonë nga zërat e ndryshëm që mund të vijnë nga sistemi ynë diellorë



**Fig 26**

apo jashtë tij.

Në këtë mënyrë shpejtësia e dritës dhe errësirës ndryshojnë nga një sferë në tjetren. Në secilin rast kur kalohet nëpër sfera shpejtësia e dritës dhe errësirës zbret.

Si shembull të thjeshtë themi se rrezet e diellit që burojnë nga dielli lëvizin me shpejtësi ( $V_1$ ) deri te sfera e tokës. Shiko figurën 26. Në këtë rast drita lakohet dhe shpejtësia e dritës zbret në ( $V_2$ ), pastaj drita me këtë shpejtësi kalon nëpër sferën e tokës, kurse në dalje të sferës prapë bie shpejtësia e dritës në ( $V_3$ ).

## Rigjenerimi i cikloneve dhe tornadove

Rigjenerimi edhe pse është një ndër pikat më të ndjeshme të shkencës, dhe e panjohshme për këtë të fundit, prapë se prapë mos njohja e fenomenit të rigjenerimit paraqet një ndër pengesat kryesore përparrimin e shkencës. Prandaj, tërështë ngashëm edhe elementet ( $aX$ ), ( $aY$ ), ( $aZ$ ) dhe ( $a\Omega$ ) gjatë ndryshimit të nivelit energjetik shndërrrohen në vetë regjenerator të mikro elementeve ( $aX'$ ), ( $aY'$ ), ( $aZ'$ ) dhe ( $a\Omega'$ ). Prandaj, elementet ( $aX$ ), ( $aY$ ), ( $aZ$ ) dhe mikroelementet ( $aX'$ ), ( $aY'$ ), ( $aZ'$ ), kanë AND dhe nivele të ndryshme energjetike. Si dhe varësish nga niveli energjetik dhe sasia e tyre janë formuar ciklonet dhe tornadot

sikur te mikrotrupat ashtu edhe te makrotrupat. Prandaj, një rritje e pakujdeshme artificiale e këtyre niveleve energetike të këtyre elementeve, qoftë edhe aksidentale shkakton probleme të pavërejtshme në fillim dhe të pa shërueshme në vazhdim, ashtu sikur i kemi përparravetës, ne i myllim sytë e bëhemë sikur nuk e dimë, apo e dimë dhe e bëjmë pa marrë parasysh se ai çmim herë kudo do jetë i shtrenjtë përgjeneratat e ardhshme tërështë pafalshme.

## Ngashmëria në mes mikrobotës dhe makrobotës

Transformimi i fushës magnetike në fushën magnetike simetrike, është një argument i natyrës se edhe te atomet, përkatësish te protonet dhe elektronet nuk kemi të bëjmë me një fushë elektrostatike, por kemi të bëjmë me një fushë elektrostatike simetrike, e cila fushë e ndryshon të kuptuarit e strukturës së brendshme të grimcave, duke ju dhanë kuptim të njëjtë me trupat qellorë. Burimi i fushës magnetike simetrike përmes rigjenerimit të protoneve, elektroneve dhe neutroneve, tregonte saktë se mikrogrimcat që burojnë nga polet magnetike nuk kthehen asnjëherë në brendi të magnetit, dhe ky mos rikthim i grimcave në brendi të magneteve ishte shkaktari kryesorë i formimit të sferave të fushave të ndryshme rrëth këtyre protoneve elektroneve, sfera të ngashme sikur te trupat qellorë. Në këtë mënyrë arrihet te përfundimi se sikur te makrotrupat rrëth të cilat rrotullohet të paktën një mikrotrup formohen nga pesë sfera që veprojnë fusha të ndryshme. Këto sfera sikur te makrotrupat ashtu edhe te mikrotrupat janë elastike, dhe të mbushura me mikrogrimca te makrotrupat, dhe mikrouarke te mikrotrupat si dhe kanë ADN të


ndryshme, që sot njohën sikur energji e zezë. Nga kjo vijmë në përfundimin se stabilitetin në mes makrotrupave dhe mikrotrupave e mbajnë pikërisht këto sfera të fushave të ndryshme.

Prandaj pa marrë parasysh energjinë e zezë ashtu sikur e njeh shkenca sot, e gjemë në brendësi të sferave sikur te makrotrupat ashtu edhe te mikrotrupat.

Kurse kjo energji nuk është asgjë tjetër përpërsë mikrogrimca të vetërigjeneruara te makrotrupat dhe mikrouarke te vetërigjeneruar te mikrotrupat. Pa marrë parasysh se sa është madhësia e makrotrupave dhe mikrotrupave, këto sfera formojnë një kufij të sigurt dhe elastik në mes këtyre dy apo më shumë trupave.

## Sferat e fushave vepruese te protonet

Ashtu sikur është cekur më lartë se nën ndikimin e tornados elektrostatike e ndryshojnë nivelin energjetik të kuarkeve ( $2/3 u$ ), ( $2/3 u$ ) dhe ( $-1/3 d$ ), të cilat shndërrrohen në vetërigjenerator të mikrouarkeve ( $2/3 u'$ ), ( $2/3 u'$ ) dhe ( $-1/3 d'$ ). Kurse një vetërigjenerim i natyrës së njëjtë pasi ndodhë edhe të elementet ( $aX$ ), ( $aY$ ) dhe ( $aZ$ ) te tornadoja dhe cikloni i protonit. Në këtë mënyrë duke u bazuar në natyrën tonë, në proceset natyrore te makrotrupat, sidomos në rrrotullimin e tokës rrëth diellit, ashtu edhe te mikrotrupat, me ç'ra stë elektronet rrrotullohen rrëth bërtamës së atomit, atëherë tërështë ngashëm edhe te protonet për shkak të vetërigjenerimeve formohen nga pesë sfera që veprojnë fusha të ndryshme. Shiko figurën 27. 1. Sfera e parë e fushës elektrostatike simetrike sekondare (+fes p) dhe 2. Sfera e dytë e fushës elektrostatike silmtrike primare (+fep p) 3. Sfera e tretë e fushës antielektrostatike simetrike (-fae p) 4. Sfera e katërt e fushës têrheqëse e ciklonit (+ftc) 5. Sfera e pestë e fushës têrheqëse e tornados elektromagnetike (+ftt). (VIJON)



<b>R<sub>5</sub></b>	<b>(aX+aY)</b>
<b>R<sub>4</sub></b>	<b>(aX+aZ)</b>
<b>R<sub>3</sub></b>	<b>(2/3 u)', (2/3 u)', (-1/3 d)'</b>
<b>R<sub>2</sub></b>	<b>(2/3 u), (2/3 u), (-1/3 d)</b>
<b>R<sub>1</sub></b>	<b>(2/3 u)", (2/3 u)', (-1/3 d)"</b>

**Fig 27**



The banner features the RC Cola logo at the top left, followed by a large yellow box containing the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". Below this, a dark blue box lists the "Quality & Sales Award Recipients" in alphabetical order. To the right, there are images of a blue can and a clear plastic bottle of RC Cola.

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fludi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



The advertisement features a circular tin of Meka Halal Food Pashtetë Pule. The tin is orange with a white lid, showing a slice of the pate with herbs and a red pepper. Text on the tin includes "MEKA HALAL FOOD", "PASHTETË PULE", "cili e garantuar!", "pa konservues", "gluten free", and "100 % mish puk". The background is orange with white, wavy, brushstroke-like patterns.

## Demokratët nuk i sigurojnë votat për t'i thirrur dëshmitarët kundër Trumpit

Uashington, 31 janar - Demokratëve në Shtetet e Bashkuara u është dhënë një goditje e madhe në përpjekjet e tyre për të thirrur dëshmitarët në gjyqin ndaj presidentit amerikan, Donald Trump. Ata kishin nevojë për katër vota të senatorëve republikanë, për të votuar në mënyrë që të lejohet paraqita e dëshmitarëve, por njëri nga senatorët tha se nuk do ta mbështes kërkasen e demokratëve.

Senatori Lamar Alexander tha se demokratët e kanë dëshmuar se Trumpi kishte vepruar në mënyrë të papërshtatshme,

por kjo nuk ishte një vepër për shkarkim.

Njoftimi i hap rrugën lirimtë mundshëm të presidentit nga Senati qysh të premten.

Në Senatin me 100 ulëse, gjenden 52 republikanë.

Presidenti amerikan akuzohet për abuzim të pushtetit në lidhje me veprimet e tij kundrejt Ukrainës, si dhe për pengim të punës së Kongresit, i cili menjëherë ka nisur hetime lidhur me veprimet e Trumpit.

Demokratët në Dhomën e Përfaqësuesve kanë thënë se Trumpi ka pezulluar ndihmën ushtarake në vlerë të 400 mil-

ionë dollarëve për Ukrainën dhe ftesën për vizitë në Shtëpinë e Bardhë për presidentin e ri ukrainas, Volodymyr Zelenskiy, duke i kërkuar Kievit që të nisë hetime kundër një rivali politik.

Trumpi ka kërkuar nga Ukraina ta hetojë Joe Bidenin, i cili është aktualisht një prej kandidatëve kyçë në garën e demokratëve për ta sfiduar Trumpin.

Përveç ish nën-presidentit amerikan, Trumpi ka kërkuar hetime edhe për djalin e Bidenit, Hunter. Trump i ka mohuar akuzat dhe gjyqin ndaj tij e ka quajtur "gjeti shtrigash".



## Lot dhe gëzim për Brexitin

Britania zyrtarisht u largua nga Bashkimi Evropian të premten në orën 11 të mbrëmjes, sipas orës lokale në Londër. Derisa mbështetësit e Brexitit kanë planifikuar festime me këtë rast, në Bruksel pati skena emocionale me largimin e ligjvënësve të fundit britanikë gjatë kësaj javë

Londër, 31 janar - Pas tre vjet e gjysmë bisedimesh të vështira dhe kaos politik që çuan në dorëheqjen e dy kryeministrave, Britania zyrtarisht u largua nga Bashkimi Evropian të premten në orën 11 të mbrëmjes, sipas orës lokale në Londër. Mbështetësit e Brexitit po planifikojnë festime me këtë rast, por në Bruksel pati skena emocionale me largimin e ligjvënësve të fundit britanikë gjatë kësaj javë. 31 janari nuk është fundi i Brexitit, përkundrazi, ai thjesht shënon fundin e fillimit të largimit të Britanisë, ka njoftuar voa.

Anëtarët e Parlamentit Evropian u dhanë një lamtumirë miqësore 73 homologëve të tyre britanikë të mëkurën, pasi miratuan kushtet e daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian.

Deputetët britanikë që mbështesin Brexitin festuan derisa kthehen në atdhe. "Ne po largohej. Liri, demokraci dhe vetëqeverisje. Ne kemi fituar!", tha Nigel Farage, anëtar britanik i Parlamentit Evropian.

Të tjerët shprehën keqardhje. "Të gjithë do t'i marrë malli për përfaqësuesit britanikë. Jo për të gjithë, për shembull, nuk mendoj se do të na mungojë Farage, por të gjithë të tjerët, po", tha Guy Verhofstadt, anëtar belg i Parlamentit Evropian.

Por me largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian në orën e fundit të së premtës, a është tanë e sigurt se procesi i Brexitit ka përfunduar? Ende jo, thotë ish-ambasadori amerikan Charlie Ries, i cili punon në Korporatën RAND. "Shumë njerëz besojnë se pas tre vjet e gjysmë debatesh mbi mënyrën se si duhet realizuar Brexit, se gjithçka është zgjidhur. Procesi nuk ka përfunduar. Në fakt, diskutimet mbi dimensionet e marrëdhënieve së re midis Britanisë dhe Bashkimit Evropian sapo kanë filluar", tha ai.

Pasiguria e vazhdueshme gjatë këtyre negociatave do t'i kushtojë Britanisë 5.5 miliardë dollarë humbe të bruto prodhimit vendor vetëm këtë vit, sipas një raporti, bashkautor i të cilët është Charlie Ries.



Boris Johnson, i cili u takua me Sekretarin e Shtetit, Mike Pompeo, të enjten, ka përfjashtuar zgjatjen e negociatave me Bashkimin Evropian përfundit të vitit 2020. "Sa më shpejt që ata ta realizojnë atë, aq më shpejt do të eliminohet pasiguria. Nga ana tjetër, nëse ata arrijnë një marrëveshje më të keqe me nxitim, atëherë ata mund të paguajnë një çmim më të lartë për një afat të gjatë për ta zvogëluar pasigurinë në një afat të shkurtër", thotë ambasadori Charlie Ries. Kryeministri Johnson dëshiron marrëveshje të shpejta tregtare me Shtetet e Bashkuara dhe vendet e tjera jashtë Evropës. "Çfarëdo që ata të fitojnë nga presa tjetër e botës nuk do t'i

kompensojë kostot e daljes nga Bashkimi Evropian", thotë ambasadori amerikan Charlie Ries.

Ndërsa Bashkimi Evropian dhe Britania fillojnë bisedimet mbi të ardhmen e marrëdhënieve të tyre, shumë çështje mbeten të paqarta, përfshirë lëvizjen e lirë të qytetarëve. "Shpresoj që negociatat nuk do të ndëshkojnë Francën. Kam miq dhe të afërm në Britani dhe nuk dua të aplikojë përvizë për t'i vizituar", thotë studentja Adophine Nsimba.

Shenjat e hershme sugjerojnë se Evropa do të kërkojë qasje në ujërat britanike për peshkim dhe garanci që Britania nuk do t'i ulë standarde e punës dhe

mjedisit të Bashkimit Evropian, në këmbim të qasjes në tregun e përbashkët të BE-së. Britania e ka përfjashtuar një marrëdhënie të tillë të ngushtë. "Tashmë ka filluar koha përafat. Njëmbëdhjetë muaj është një periudhë kohore jashtëzakonisht e shkurtër", tha Michel Barnier, kryenegotiator i BE-së për Brexitin.

Vetë Britania po vihet nën tension gjithnjë e më të madh, me Skocinë që kërkon një votë përvavarësi në mënyrë që të mund të anëtarësohet përsëri në BE.

Brexit do të festohet nga mbështetësit e saj me koncerte në Londër dhe qytete të tjera. Por 31 janari është vetëm fundi i kapitullit të parë në dramën e gjatë të Brexitit.

## Erdogani kritikon shtetet arabe që mbështesin planin e Trumpit


ANKARA, 31 JANAR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka kritikuar disa shtete arabe për mbështetje të planit për paqe në Lindjen e Mesme, të prezantuar këtë javë nga Shtetet e Bashkuara, duke e cilësuar këtë veprim si "tradhti". "Disa shtete arabe që kanë mbështetur këtë plan kanë kryer tradhti kundër Jerusalemit dhe vetë njerëzve të tyre, por çfarë është më e rëndësishme kundër gjithë njerëzimit", u ka thënë Erdogan pjesë-

tarëve të partisë së tij në Ankara. Erdogan, një mbrojtës i madh i të drejtave të palestinezëve u është referuar Arabisë Saudite, Emirateve të Bashkuara Arabe, Bahreinit dhe Omanit kur ka bërë këto kritika. "Arabia Saudite, ju në veçanti jeni e heshtur. Kur do ta thyeni heshtjen?", ka pyetur ai.

"Turp ju qoftë! Turp ju qoftë! Këto duar që duartroasin planin, si do të jepin përgjegjësi për këtë tradhti?", ka deklaruar

mes tjerash ai. Të martën presidenti amerikan Donald Trump ka prezantuar detajet e planit për zgjidhjen e konfliktit izraelito-palestinez. Në njoftimin e tij Trumpi ka thënë se Jerusalemi do të mbetet "kryeqytet i pandarë" i Izraelit, mirëpo ka parashikuar zgjidhje me dy shtete. Palestinezët në anën tjetër pretendojnë që Jerusalemin Lindor ta shpallin kryeqytet të shtetit të tyre në të ardhmen.





# Stevenson: Nga idetë e fundit

Nga Aurel PLASARI

Emri Robert Louis Stevenson (1850-1894) është tanimë ai i një shkrimtari botëror. Më së shumti i lexuar si shkrimtar aventurash ose ndryshe peripecish, – “Ishulli i thesarit”, “Shigjeta e zezë”, “Rasti i çuditshëm i doktor Xhekillit dhe zotit Haid” etj. – më pak është njojur si autor shënimesh udhëtimi, si eseist, si kritik letrar etj. Edhe për vete prej romanave të aventurave kam pas bërë të njojur me të qysh prej magjepsjes në fëmijëri nga “Ishulla e thesarit”, që në ato kohë nuk duhej qarkulluar: “Ishulla” ishte e ndaluar pér shkak të përkthyesit të saj të përsyshur, Tajar Zavalanit. Po njësoj qenë të ndaluara, prej Zavalanit themelues të përkthimit modern shqiptar në vitet ’30 të shekullit të kaluar, edhe “Zonja me kameliet”, edhe “Tartarini i Taraskonit”, edhe “Gobsekut”, edhe “Sonata e Krocerit”, madje edhe “Anna Karenina” e tij etj.

I pasionuar i udhëtimeve, i përfytyruar gati-gati si vagabond, vitet e fundit të jetës Stevensoni i përfundoi duke u endur ndër ishujt e

Paqësorit Jugor. Aty në ishujt Samoa edhe u vendos, më së fundi, tok me familjen e përbërë nga e bija dhe i biri të gruas së tij prej martesës së saj të parë, tanimë e vdekur, Bella dhe Lloyd Osbourne. Këta e respektuan dhe e deshën “njerkun” si atin e tyre. Për këtë bir të sjellë nga gruaja, Lloydin dikur 15-vjeçar, Stevensoni kishte pas shkruar të parën vepër të vet famëmadhe, “Ishulli i thesarit”, atë roman të cilin edhe Borgesi e paska përfjetuar – para nesh – si një nga format e lumturisë në fëmijëri.

Thjeshtri i tij Lloyd Osbourne tanimë i rritur, që më mbas do të bëhej edhe vetë shkrimtar, i qëndroi pranë Stevensonit deri në fund duke e përkujdesur dhe duke ia plotësuar deri edhe amanetin ekscentrik pér banesën pasvdekësore. Ai ka shënuar e treguar edhe bisedat më të fundit me shkrimtarin në ndërkohët e lira ndërsa ky shkruante të pambaruarin “Weir of Hermiston”, ndoshta kryeveprën e vet. Kuptohet, prej bisedash të tillë, që Robert Louis Stevensoni nuk paskësh qenë thjesht ndonjë “aventurier” bredharak i dhënë mbas jetës nomade, por njeri mendimi të thellë. Dhe jo më kot

me veprat e veta paskësh para-pëlqyer t'i ikte “realitetit borgjez” duke thurur èndërrime me vise vetmitare gjithë magji. Një mbrëmjeje, ndërsa shëtisin para lëndinës së shtëpisë, shkrimtari i mirëbesohet Lloydit: “Nuk jam njeri me ndonjë talent të jashtëzakonshëm, Lloyd. Kam filluar me mundësi shumë të pakta. Suksesi im i dytërohet zel-lit tim të jashtëzakonshëm pér punë, falë të cilit zhvillova deri në skaj gjithë sa pata në vete. Kur një njeri fillon t'i përkryej aftësitë e veta dhe vijon t'i përkryej ato me ngulm të pareshtur, mund të bëjë mrekulli. Të gjithë e dinë, të gjithë e kuptojnë, e megjithëkëtë sa e vështirë është të gjesh dikë që ta bëjë! E kam fjalën që ta bëjë deri në fund, siç e bëra unë. Në pati tek unë ndonjë gjë gjeniale ishte gjenia e punës.”

Një ditë tjetër, i ulur në verandë në karrigen e tij të xunkthit, i bën këtë pohim kërshëror: “Çdo shkrimtar që vlen diçka, vdes dhe rilind papushim. Dje po lexoja “Virginibus Puerisque” dhe m'u duk mjaft i mirë, por i lindur nga një dell që tanimë do ta kisha të pamundur ta ngjallja sërishti aq sa do ta kisha të pamundur të fluturoja. Tani puna ime është më e

thellë nga ajo e dikurshmja, mund të mbërrrij emocione të cilat asohere mezi i dija që ekziston. Kjo do të thotë se Stevensoni që shkroi “Virginibus” ka vdekur dhe është varrosur, madje prej shumë motesh.”

Atje, në ishujt gjysmë të egër të Paqësorit Jugor, shkrimtari shfryni para mikut Lloyd: “Sa keq që e përdorin francezët lirinë e tyre! Nuk shohin tjetër gjë që t'ia vlejë përpos trekëndëshit të përjetshëm; ndërsa ne, që kemi mëgojëzën në gojë si qentë, dhe një kënd vështrimi pafundësish më të gjerë, jemi të dënuar ta injorojmë gjysmën e jetës që na kalon përbri. Ç'libra do të kishte mundur të shkruante Dickensi po t'ia kishin lejuar! Përfytyro një Thackeray pa zinxhirë, të lirë si një Flaubert a një Balzac! Ç'libra do të kisha mundur të shkruaja unë vetë! Mirëpo neve na jipin një kutizë me lodra e na thonë: ‘Nuk duhet të luani veçse me këto.’”


Një ditë tjetër: “Arma e borgjezisë është uria. Nëse ti si shkrimtar ose si artist shkon kundër opinioneve të tyre të ngushta, ata në heshtje e thjesht fare të heqin mjetet e jetesës. Nganjëherë pyes veten se sa persona gjenialë

dënohen në këtë mënyrë çdo vit.” Kurse një mbasdite, ndërsa miqtë atypari luajnë tenis: “Ne nuk jetojmë pér nevojat e jetës, pér to në fakt askush nuk çan kokë; ne jetojmë thjesht pér gjérat e teperta, të kota [superfluities].” Madje në një moment: “Spektakli më i trishtë i qytetërimit dhe pér mendimin tim dëshmia më e madhe e dështimit të qytetërimit, është njeriu që mund të punojë, që do që të punojë dhe të cilit nuk i lejohet të punojë.” Shkrimtari vdiq më 3 dhjetor 1894 po në Samoa. Me ndihmën e vendave që e adhuronin njeriun Stevenson, Lloyd Osbourne-i e varrosi aty, simbas amanetit, në një majë mal: së andejmi vështrohej deti përpara, mbas shpine një pyll zanafillor, humnera, ujëvara të largëta dhe një visore që, me gjasë, këmbë e njeriut nuk e kishte shkelur ndonjëherë. Po asaj mbrëmjeje u ul e filloj të hidhët në një blocknote kujtimet me titull *Vdekja e Stevensonit*. Janë nga ato kujtime falë të cilave lexuesit mund t'i njohin shkrimtarët edhe prej jetës së tyre, sidomos mendimeve të tyre, jo vetëm prej teksteve “fikcionale”. /Exlibris

## E jashtëzakonshme

## Polakët ndërtojnë labirintin më të madh në botë nga bora

Në Poloni është ndërtuar labirinti më i madh në botë prej bore, që po tërheq në masë të madhe vëmendjen e banorëve lokalë, por edhe të turistëve. Labirinti nga bora që duket si një ndrra gjendet në Zakopane në kufi më Sllovinë. Zakopane është një qytet i vogël



dhe shumë i njohur për sportet dimërore, por edhe për numrin e madh të turistëve.

## FOTO E DITES



Një grumbull zogjsh shihen në Masua në Luginën Jordan në Bregun Perëndimor të okupuar. /AFP/

## E rrallë

## Grabitet galeria e artit, skulptura dhe piktura me vlerë 500 mijë euro

Skulpturat dhe pikturat e artistit Salvador Dalí me vlerë rreth 500 mijë euro u vodhën nga një galeri arti në Stockholm, Suedi. Grabitësit thyen dritaret e galerisë Couleur dhe boshatisën të gjithë sallën ku ishin vendosur veprat e artit. Policia po vazhdon hetimet dhe



po sheh kamerat e sigurisë për t'i identifikuar autorët e vjedhjes të cilët u larguan nga vendi i ngjarjes me makinë. Por veprat e Dalit kanë rënë pre e grabitjeve edhe më parë.



**DASHI**  
Sot në portofolin tuaj do të ketë shumë para. Mund të ndodhin shumë situate të papritura, prandaj bëni mirë të jeni të përgatitur.



**DEMI**  
Në vend se të gjeni njerëz të rinj, gjëra dhe ide për të eksploruar, eshtë koha të kontaktoni me një mik të vjetër.



**BINJAKËT**  
Nëse keni menduar të bëni një udhëtim, biletat prijini sot. Dhe nëse keni dashur gjithë këtë kohë të fusni në jetën tuaj dikë që ju e pëlqeni, uleni para vetes dhe shprehjani dashurinë tuaj.



**GAFORRJA**  
Këndvë-shtrimi juaj realist do t'ju ndihmojë të përshtateni në çdo situatë, të jeni më të vetëmjaftueshmë dhe të jeni shumë më efektiv në çdo negociatë në të cilën duhet të filloni sot.



**LUANI**  
Sot jeni të pavendosur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mosnjohjes së personave që do të keni përballë gjatë ditës.



**VIRGJERESA**  
Dita juaj po vjen së shpejt, thjesht duhet të presësh. Në jetën tuaj personale, disa situate stresuese me të cilat jeni marrë kohët e fundit, përfundimisht janë larguar.



**PESHORJA**  
Kaloni ditën tuaj duke u përpjekur t'i kuptioni njerëzit në jetën tuaj dhe shfaqni më të mirën tuaj sot. Nëse e nuk bëni, nuk do të jeni më në qendër të vëmendjes nga ata për një kohë të gjatë.



**AKREPI**  
duhet të bëni, prandaj vendosni kufjet, zhvendosni në një tavolinë tjetër ose përpikuni të punoni në shtëpi në mundeni.



**SHIGJETARI**  
Mos i besoni të gjitha historitë që dégjoni përdikë. Mund të jenë argëtuese, por jo të vërteta. Mendoni si do të ndiheshit nëse dikush do t'ju përfiste përdikë aspak të vërtetë.



**BRICJAPI**  
tivitetin tuaj sepse do t'ju ndihmojë me shumë gjëra që do të përballeni gjatë ditës.



**UJORI**  
Shpirti juaj kreativ do të jetë në nivele të larta. Ju nuk gaboni në zgjedhjen e një artikulli në dyqane rrobash.



**PESHQIT**  
Çështjet që kanë të bëjnë me dashurinë do të jetë favorin tuaj sot. Është një forcë që ju shtyn të ndërmerrni veprime.

## BARSOLETA E DITËS

## Plaku dhe djali:

- A po e agjeron ramazanin?, e pyet djali plakun.
- Po more krejt, i përgjigjet plaku.
- Ta boftë Zoti kabull!, i uron i ri.
- Ty ta boftë Afganistan!, ia kthen plaku.




## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00  
**Spies in Disguise 3D**

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka



**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno

Në ora 18:00  
**Jumanji; The Next Level 3D**

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00  
**STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D**

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams

Çdo natë në ora 22:30  
**THE GRUDGE**

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

## Hailey Baldwin kopjon Katie Holmes



**A**keni menduar se Katie Holmes është i vetmi yll i Hollywoodit që mund të shkëlqejë me sutjena nga kashmiri? Gati gjysmë viti pasi ylli i "Dawson's Creek" kishte bërë bujë në rrjetet sociale kur kishte guxuar të vishtë sutjena të kombinuara me një sako,


Hailey Baldwin ka zgjedhur që sutjenat t'i kombinojë me një veshje më zyrtare. Modeluesja 23-vjeçare kishte veshur sutjenat Mandkhai ngjyrë kafe (202 dollarë), derisa pantallonat dhe sakoja që ishte Bottega Veneta (2980 dollarë) ishin po të së njëjtë ngjyrë.

## Taylor Swift nuk shkoi në Grammys sepse s'ishte e sigurt që do të fitonte



**A**rsyeja e vërtetë pse Taylor Swift nuk shkoi në ceremoninë e Grammys është për shkak se nuk ishte e garantuar se ajo do ta fitonte çmimin "Song of the Year". Burime të shumta kanë konfirmuar për "Page Six" që ekipi i Swiftit ka

biseduar me personat e shout para ceremonisë dhe kanë thënë se Swifti do ta performonte këngën e saj nëse do të fitonte Grammy. Por ekipi i Swift tha se fituesit nuk janë të njeror për këtë plan dhe se nuk do t'i thyenin rregullat për të.



## Dua Lipa tregon datën e publikimit të albumit të ri

Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Kosova, Dua Lipa, ka bërë me dije se kur do ta publikojë albumin e ri. Ajo me anë të një

postimi në rrjetin social "Facebook" ka pohuar se "Future Nostalgic" do të publikohet më 3 prill.

## Grande, Cabello dhe Garner me qaforen e njëjtë dy milionë dollarësh



**D**iamantet janë miqtë më të mirë të një vajze. Prandaj, edhe nuk është aspak çudi që yjet duan të shkëlqejnë në tapetin e kuq, jo rrallëherë edhe me bizhuteri që kanë vlerë miliona dollarë. Por, ndonëse është rrallë t'i shohim ftyrat e njeruara me bizhuteri të njëjtë, qaforja me diamante nga "Le Vian" që kush-ton hiç më pak se 2 milionë dol-

larë. Ishte Ariana Grande ajo që u pa fillimisht me të në MTV Video Awards në vitin 2016. Në muajin tetor të vitit 2019 Jennifer Garner është parë me të njëjtën qafore që ka plot 65 karatë në një ngjarje gala, derisa së fundmi Camila Cabello e kishte kombinuar qaforen e mbushur me diamante me fustanin seksi të "Atelier Versace" në Grammys.



# Hadergjonaj: Jam shumë i lumtur që jam këtu

Florent Hadergjonaj ka ndërruar klub në ditën e fundit të afatit kalimtar. Ai i është bashkuar mbrojtësit shqiptar, Loret Sadikut, te Kasimpasa. Hadergjonaj ka synim të luajë sa më shumë minuta me klubin e ri dhe të jetë i gatshëm për formacionin bazë të Kosovës në ndeshjen e muajit mars në Ligën e Kombeve ndaj Maqedonisë së Veriut. Në këtë afat kalimtar klub kanë ndërruar edhe dy futbollistët e tjerë “dardanë”, Valon Berisha dhe Donis Avdijaj, kurse Amir Rahmani ka nënshkruar për Napolin dhe do t'i bashkohet në fund të këtij edicioni



**“Epoka e re”**

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Anëtari i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Florent Hadergjonaj, është bërë të premten me skuadër të re. Futbollisti “dardan” e ka braktisur klubin anglez Huddersfield Town dhe i është bashkuar klubit turk, Kasimpasa. Hadergjonaj është shprehur i lumtur me priten që i është bërë në skuadrën nga Stamboli, kurse ka bërë me dije se gjithmonë ka pasur dëshirë që ta vizitojë këtë qytet. “Faleminderit shumë për këtë prite të ngrohtë. Që nga fillimi, kur i kemi filluar negociatat, jam ndier shumë rehat. Kemi pasur biseda të mira. Ishte një proces i gjatë, që të jem i sinqtë, zgjati disa ditë, por tani është mirë. Jam shumë i lumtur që jam këtu dhe që më në fund u arrit transferimi. Kjo është hera ime e parë këtu [Stamboll], por kam dashur gjithmonë ta vizitoj Stambolin. Është një qytet i

mrekullueshëm. Tani që do të luaj në këtë qytet, ndoshta do të mund të dal t'i vizitoj disa vende”, ka thënë Hadergjonaj, i cili më pas ka bërë me dije se para se ta pranonte ofertën e Kasimpasës është konsultuar me lojtarin shqiptar, Loret Sadiku. Hadergjonaj tregon se mbrojtësi Sadiku i ka folur fjalë të mira për klubin e tij dhe qendrën stërvitore. “Kam folur me disa shokë që luajnë në ligën turke dhe që e njohin Kasimpasan më mirë sesa unë. Kam folur edhe me Loret Sadikun. Ai më tha se qendra stërvitore është shumë e mirë. Por, tani jam shumë i befasuar kur po e shoh me sytë e mi. Ky klub u jep lojtarevë mundësi të përmirësohen. S'kam pasur kurrë më parë në jetë qendrën stërvitore. Është shumë profesionale dhe kemi gjithçka këtu. Jam shumë i lumtur që jam këtu”, ka deklaruar Hadergjonaj.

Kasimpasa aktualisht është në pozitën e 16, kurse lidhur me këtë fakt 25-

vjeçari ka paralajmëruar se tifozët duhet t'i qëndrojnë afër skuadës në mënyrë që ajo t'u rikthehet rezultateve pozitive. “Kjo është një periudhë e vështirë jo vetëm përlotarët, por edhe përtifozët. Nuk është e lehtë, por shpresoj se ata do të vazhdojnë të na përkrahin dhe të na nxisin sepse ne e dimë se kemi nevojë përt ta. Tani ne lojtarët duhet t'i marrim pikët dhe t'i gjëzojmë tifozët, të cilët janë gjithmonë këtu përt ne”, ka deklaruar ai.

Në vitin 2017 Hadergjonaj ishte huazuar nga Ingolstadi te Huddersfieldi, kurse ai ka bërë 73 paraqitje përt këtë skuadër, por pasi humbi vendin në formacionin e parë, vendosi të largohet dhe t'i bashkohet Kasimpasës në formë huazimi deri në verë. Synim i lojtarit është të luajë sa më shumë minuta me klubin e ri në mënyrë që të jetë i gatshëm për formacionin bazë të Kosovës në ndeshjen e muajit mars në Ligën e Kombeve ndaj Maqedonisë së Veriut.

## SHKURT

### Besa përforcohet me 6 futbollistë

Besa ka konfirmuar përforcimet e janarit, bën të ditur fajja zyrtare e klubit pejan. Besa e Pejës e ka seriozisht garën për rikthim në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra pejane ka zyrtarizuar gjatë transferimet e bëra në këtë afat kalimtar. Bëhet fjalë për Alemdin Muratin, Qëndrim Dautajn, Agon Xhakën, Bazo Rajoviqin, Endrit Binakajn dhe Florent Molliqajn. “Besa arri marrëveshje me këta super-futbollistë, me çka e vulosi rrugën drejt inkuadrimit në Superligën e Kosovës në futboll”, thuhet në njoftimin e Besës.

### Liria prezanton Gjerajn, Shalën dhe Demirganin

Liria e Prizrenit zyrtarizoi arritjen e marrëveshjes me Robert Gjerajn, që rikthehet në klub nga Besa e Pejës, Uran Shalën nga Ballkani, i dalë vite më parë nga Shkolla e KF Liria dhe portierin nga klubni Cizrespor (Turqi), Mahmut Demirgan. “Me këto ardhje Liria do t'i përbillye prurjet në këtë afat kalimtar”, ka thënë Durak Thaçi, zëdhënës i klubit prizrenas. Liria përgatitjet për sezonin pranveror do t'i zhvillojë në Durrës.

### Trajneri i Hajdukut: Unë e ndalova shitjen e Ismajlit

Ishte përfolur për një largim Ardian Ismajli nga Hajduku i Splitit, atje ku ka qenë një titullar i padiskutueshëm dhe ka zhvilluar ndeshje të nivelit të lartë. Disa ekipe të njohura dhe nga Seria A kanë paraqitur ofertat e tyre përt ta marrë në merkaton e dimrit, por që nuk e kanë bindur klubin kroat përvlerën që ofronin. Së fundmi është vetë trajneri i Hajdukut, Tudor, që shprehë mbi këtë situatë. “Unë e kam ndaluar personalisht shitjen e Ismajlit, sepse nëse dikush dëshiron që ta marrë, atëherë duhet të vendosë një ofertë serioze dhe para në tryezë. Kam parë që në Itali shiteshin disa mbrojtës përmiliona, por nuk ishin as sa gjysma e Arđianit”, ka thënë Tudor.

### Shitja e Muriqit nuk ishte në opzioni të Fenerbahçes

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, është lidhur vazhdimesh me një kalim në Premierë Ligë, por agjenti i lojtarit, Haluk Cantar, ka thënë se janë të lumtur me ofertat përsulmuesin shqiptar, por Fenerbahçe nuk e ka pasur në plan shitjen e tij. “Muriqi është në kontratë katërvjeçare me klubin e Fenerbahçes. Jemi të lumtur që përt të kanë shprehur interesim klube të ndryshme, por nuk bëhet fjalë për një largim në afat të janarit”, ka thënë ai. Muriqi ka shënuar 12 gola dhe 4 asistime në 17 ndeshje të Superligës turke deri tani.

## Clippersat mposhten nga Kingsi, fitojnë Bostoni dhe Toronto

**LOS ANXHELOS, 31 JANAR** - Në sfidën në mes të Los Angeles Clippersit ndaj Sacramento Kingsit u paraqitën edhe dy fanellat e 16 herë kampionëve të NBA-së, me numrat 8 dhe 24,

me të cilët Kobe Bryant ka arritur suksese të madhe, ndërkokë që ndeshja u luajt në një klimë surreale për tragjedinë që i ndodhi ish-yllit të Lakersave. Skuadra e Doc Riversit, pa Kawhi

Leonard, u mposht lehtësisht nga Sacramento Kingsi me rezultatin 103-124. Dallimin në këtë sfidë e bëri Fox me 34 pikë, 3 rebounde dhe 8 asistime, ndërkokë që për Clippersat më i

miri mbi parket ishte Lou Williams me 22 pikë. Golden State Warriors pësoi humbjen e 15-të në 16 ndeshjet e fundit pasi u thyte nga Boston Celtics me rezultatin 119-104. Vilon



## Ylli - Rahoveci, derbi i javës në basketboll

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Në fundjavë do të zhvillohet xhiroja e 24-të Superligës së Kosovës në basketboll. Kjo xhiro do të sjellë shumë ndeshje interesante. Ndeshja e parë do të zhvillohet në mes të Bashkimit dhe Ponte Prizrenit, një takim interesant ku përballe njëra-tjetërës do të jenë dy skuadrat e Prizrenit. Ndesjet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritet të jetë edhe të shtunën. Bashkimi ka 12 fitore dhe tetë humbje, kurse Ponte Prizreni 13 fitore dhe tetë humbje. Përballa tjetër e së shtunës do të zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Pejës, dy skuadrave me traditë në basketbollin e Kosovës.



### SUPERLIGA - Java 24

Të shtunën takohen:  
17:00 Bashkimi - Ponte Prizreni  
19:00 Trepça - Peja

Të dielën takohen:  
17:00 Golden Eagle Ylli - Rahoveci  
19:00 Lipjani - Sigal Prishtina  
Feronikeli (pushon)

Mitrovicasit kanë katër fitore dhe 16 humbje, derisa pejanët 12 fitore dhe tetë humbje. Ndesha më interesante e kësaj jave do të zhvillohet ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Rahovcit. Takimet në vitet e fundit mes këtyre skuadrave kanë qenë shumë interesante dhe dramatike. Ylli ndodhet në vendin e tretë me 34

pikë (14 fitore dhe gjashtë humbje), ndërsa Rahoveci është lider me 37 pikë (16 fitore dhe pesë humbje). Takimi i fundit do të zhvillohet ndërmjet Lipjanit dhe Sigal Prishtinës. Lipjanasit kanë një fitore dhe 20 humbje, kurse prishtinasit kanë 15 fitore dhe pesë humbje. Feronikeli pushon në këtë xhiro.

## 10 klube aplikojnë për licencën për garat e UEFA-s

**PRISHTINË, 31 JANAR** - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës u zhvillua seminari i radhës nga Departamenti i Licencimit të klubeve për garat e UEFA-s. 10 klube nga të dyja gjinitë, 9 të meshkujve dhe 1 i femrave kanë aplikuar për t'u pajisur me licencën për garat e UEFA-s dhe përfaqësuesit e tyre ishin pjesë e këtij seminari. "Prezantimi i klubeve të Kosovës në garat ndërkombëtare, afatet për dorëzimin e dokumentacionit dhe pikat specifike të rregullores ishin disa prej temave të diskutimit, kurse pikë kryesore ishte diskutimi i përbashkët ndërmjet administratës për licencim, komisionit të shkallës së parë dhe përfaqësuesve të klubeve në lidhje me vështirësitë e shfaqura gjatë viteve të kaluara në procesin e licencimit", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Menaxheri për licencimin e klubeve për garat e UEFA-s, Bajram Shala, ua komunikoi edhe zyrtar-



isht klubeve që në edicionin 2020-2021 Kosovën në garat evropiane do ta përfaqësojnë tri klube, një në rrëthin parakualifikues të Ligës së Kampionëve dhe dy në rrëthin parakualifikues të Ligës së Evropës. Kurse nga viti i ardhshëm, në edicionin 2021-2022, klubet kosovare

do të marrin pjesë në Champions League dhe në Europa Conference League. Më pas u diskutuan gjërisht pikat kyçe, sidomos te kriteri finanziar dhe ai ligjor, kritere në të cilat klubet kanë pasur më së shumti vështirësi në proceset e kaluara të licencimit.

### SHKURT

#### Gerrardi kërkon Kamberin te Rangersi

Florian Kamberi është gati ta bëjë kapercimin e madh në karrierën e tij. Sulmuesi i grumbulluar rishtazi nga Edi Reja në kombëtaren e Shqipërisë kërkohet nga Glasgow Rangersi. Lajmi bëhet me dije nga mediat skoceze. Sipas tyre, Steven Gerrardi i ka sugjeruar klubit transferimin e futbollistik që luan me Hibernian. Rangersi ofron një formulë huazimi me të drejtë blerje në fund të sezonit. Kamberi e dëshiron edhe skuadra polake Lech Poznan.

#### Thiem në finale të Australian Open

Tenisti Dominic Thiem ka kaluar në finalen e Grand Slam turneut të tenisit në Australian Open. Bartësi i katërt u rikthyse pasi humbi setin e parë duke fituar në fund me rezultat 3-6, 6-4, 7-6, 7-6 kundër Alexander Zverev në tri orë e 42 minuta lojë në Rod Laver Arena. Kjo është hera e parë që austriaku arrin finalen e Australian Open. Në finale ai do të ndeshet me shtatë herë kampionin Novak Djokoviç. 26-vjeçari në të kaluarën kishte qenë finalist i mposhtur në dy Grand Slam turne nga Rafael Nadal në Roland Garros më 2018 dhe 2019.

#### Bishop në United

Manchester Unitedi ka marrë në ekipin e vet portierin Nathan Bishop. Unitedi ka arritur marrëveshje përmarrjen e Bishopit nga Southend United. Portieri i Kombëtares angleze U-20 ka nënshkruar kontratë përvjetorë me Unitedin.

#### Florenzi huazohet te Valencia

Në moshën 28-vjeçare Alesandro Florenzi i jep për herë të dytën lamtumirën Romës dhe e bën sërisht në huazim tashmë për vetëm 6 muaj dhe jo për një vit siç ndodhi në sezonin 2011-2012 kur luajti për Crotone. Florenzi është zyrtarisht futbollist i Valencias teksha është transferuar te Los Che në formë huazimi deri në fund të këtij sezoni. Ish-kapiteni i klubit verdhekuq është prezantuar te Valencia, ndërkokë që me një postim në "Instagram" ka falenderuar Romën dhe ka bërë të ditur se gjithmonë do të jetë një fans i skuadrës kryeqytetase.

#### Atletico rikthen Carrasco

Atletico Madridi e ka zyrtarizuar transferimin e Yannick Ferreira Carrasco nga skuadra kineze, Dalian Yifang. Carrasco është rikthyer në skuadrën spanjoll, por kësaj radhe në formë huazimi. "Ne kemi arritur një marrëveshje me Dalian për belgun që të bashkohet me Atletico Madridin si huazim. 26-vjeçari kthehet në klubin tonë, ku ai luajti 124 ndeshje dhe shënoi 23 gola gjatë tre sezoneve", thuhet në njoftimin e klubit spanjoll.

#### Alcaceri nënshkruan kontratë pesëvjeçare me Villarrealin

Paco Alcacer është prezantuar në skuadrën e Villarrealit. Sulmuesi ka firmosur përmarrjen spanjolle deri në vitin 2025, kurse "Nëndetësja e verdhë" i pagoi Borussia Dortmundit 23 milionë euro. 26-vjeçari ka luajtur edhe për Valencian, Getafén dhe Barcelonën. Ndërsa përmarrja e Spanjës është paraqitur në 20 ndeshje dhe ka shënuar 12 gola.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Administracije  
Ministry of Public Administration

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Administratës Publike bën:

### Shpallje të Konkursit Publik me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

#### I.Titulli i punës : Zyrtar i Lartë Profesional (Ndërtimtarisë, 2 vende te punës)

Nr.ref.- MAP-DSPIMNQ

Kategoria funksionale : Nivel Profesional

Koeficienti : 8

Lloji i pozitës :Kontratë mbi vepër

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar

Vendi i punës : Prishtinë, Ndërtesa ish „Rilindja”

#### Qëllimi i vendit të punës :

Të përgatitë dokumentacionin teknik komplet , të mbikqyren punimet gjatë ekzekutimit dhe dokumentacioni i pagesave për projektet e renovimeve ose ndërtimeve të ndërtesave të Qeverisë në nivel qëndror dhe komunal të lëmisë së ndërtimtarisë sipas standardeve teknike në fuqi .

**Nëpunësi raporton te :** Udhëheqësi i Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare

#### Detyrat dhe përgjegjësitet:

- Të menaxhojë, mbikqyrë, kontrolloj realizimin e planeve të aprovuara të mirëmbajtjes ,
- Të koordinoj dhe ngrit nivelin e bashkëpunimit dhe profesionalizmin në kryerjen e aktiviteteve të njësise dhe më gjérë,
- Të menaxhon, kontrollon dhe mbikqyrë realizimin e obligimeve për kryerje të shërbimeve, liferime të mallrave të ndryshme, azhurimin e shënimive në mënyrë periodike,
- përgatitë dokumentacionin për projektet, përfshirë dizajnet, kalkulimet, përshkrimet teknike, paramasat dhe parallogaritë , dokumentet tjera përcjellëse,
- Të mbikëqyr punët ndërtimore në punishte të projekteve dhe kontrollon librin ndërtimor e ditarin e punës për ç do ditë,
- Të menaxhojë , kontrollojë sistemin e pagesave që të realizohet sipas kushteve të kontratës për projektet me të cilët është i ngarkuar nga udhëheqësi,
- Kontrollon dhe përcakton tipin dhe kualitetin e materialit që do të përdoret gjatë ekzekutimit të punimeve, që ti përm bush kushtet sipas standardeve teknike ,
- Të kryej ndonjë detyrë tjetër sipas kërkesës nga mbikëqyrësi.

#### Shkathësitë e kërkua:

- Fakulteti teknik drejtimi : Bachelor i Ndërtimtarisë ,
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale,
- Përvojë dhe aftesi të mira ne programet per Vizatim,
- Njohuri të mirë pune me kompjutor ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ), Njohuri për implementimin e sistemeve të BMS për MenaxhiminAutomatik të ndërtesave,
- Aftesi të mira komunikuese më gojë dhe me shkrim të gjuhës shqipe, e dëshiruesheme e gjuhës angleze dhe sérbokroate,
- Aftesi për punë në ekip, dhe përm bushje të detyrave dhe punëve të vështira.

#### II.Titulli i punës : Zyrtar i Lartë Profesional (Arkitekturë ,1 vend pune)

Nr.ref.- MAP-DSPIMNQ2020/2

Kategoria funksionale : Nivel Profesional

Koeficienti : 8

Lloji i pozitës :Kontratë mbi vepër

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar

Vendi i punës : Prishtinë, Ndërtesa ish,, Rilindja”

#### Qëllimi i vendit të punës :

Të përgatitë dokumentacionin teknik komplet , të mbikqyren punimet gjatë ekzekutimit dhe dokumentacioni i pagesave për projektet e renovimeve ose ndërtimeve të ndërtesave të Qeverisë në nivel qëndror dhe komunal të lëmisë së ndërtimtarisë sipas standadeve teknike në fuqi .

**Nëpunësi raporton te :** Udhëheqësi i Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare

#### Detyrat dhe përgjegjësitet:

- Të menaxhojë, mbikqyrë, kontolloj realizimin e planeve të aprovuara të Mirëmbajtjes ,
- Të koordinoj dhe ngrit nivelin e bashkëpunimit dhe profesionalizmin në kryerjen e aktiviteteve të njësise dhe më gjérë,
- Të menaxhon, kontrollon dhe mbikqyrë realizimin e obligimeve për kryerje të shërbimeve, liferime të mallrave të ndryshme, azhurimin e shënimive në mënyrë periodike,

- Përgatitë dokumentacionin për projektet, përfshirë dizajnet, kalkulimet, përshkrimet teknike, paramasat dhe parallogaritë , dokumentet tjera përcjellëse
- Të mbikëqyr punët ndërtimore në punishte të projekteve dhe kontrollon librin ndërtimor e ditarin e punës për ç do ditë,
- Te menaxhojë , kontrollojë sistemin e pagesave që të realizohet sipas kushteve të kontratës për projektet me të cilët është I ngarkuar nga udhëheqësi,
- Kontrollon dhe përcakton tipin dhe kualitetin e materialit që do të përdoret gjatë ekzekutimit të. punimeve, që ti përm bush kushtet sipas standardeve teknike,
- Të kryej ndonjë detyrë tjetër sipas kërkesës nga mbikëqyrësi.

#### Shkathësitë e kërkua:

- Fakulteti teknik drejtimi : Bachelor i Arkitekturës,
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale,
- Përvojë dhe aftesi të mira ne programet për Vizatim,
- Njohuri të mirë pune me kompjutor ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ),
- Njohuri për implementimin e sistemeve të BMS për MenaxhiminAutomatik te ndërtesave ,
- Aftesi të mira komunikuese më gojë dhe me shkrim të gjuhës shqipe, e dëshiruesheme e gjuhës angleze dhe sérbokroate,
- Aftesi për punë në ekip, dhe përm bushje të detyrave dhe punëve të vështira.

#### III.Titulli i punës : Zyrtar i Lartë Profesional (Elektroteknikë 1 vend pune )

Nr.ref.- MAP-DSPIMNQ-2020/3

Kategoria funksionale : Nivel Profesional

Koeficienti : 8

Lloji i pozitës :Kontratë mbi vepër

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar

Vendi i punës : Prishtinë, Ndërtesa ish „Rilindja”

#### Qëllimi i vendit të punës :

Të përgatitë dokumentacionin teknik komplet , te mbikqyren punimet gjatë ekzekutimit dhe dokumentacioni I pagesave për projektet e renovimeve ose ndërtimeve të ndërtesave të Qeverisë në nivel qendror dhe komunal të lëmisë së ndërtimtarisë sipas standadeve teknike në fuqi .

**Nëpunësi raporton te :** Udhëheqësi i Divizionit të Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare

#### Detyrat dhe përgjegjësitet:

- Të menaxhojë, mbikqyrë, kontolloj realizimin e planeve të aprovuara të Mirëmbajtjes ,
- Të koordinoj dhe ngrit nivelin e bashkëpunimit dhe profesionalizmin në kryerjen e aktiviteteve të njësise dhe më gjérë,
- Të menaxhon, kontrollon dhe mbikqyrë realizimin e obligimeve për kryerje të shërbimeve, liferime të mallrave të ndryshme, azhurimin e shënimive në mënyrë periodike,
- Përgatit dokumentacionin për projektet, përfshirë dizajnet, kalkulimet, përshkrimet teknike, paramasat dhe parallogaritë , dokumentet tjera përcjellëse,
- Të mbikëqyr punët ndërtimore në punishte të projekteve dhe kontrollon librin ndërtimor e ditarin e punës për ç do ditë,
- Të menaxhojë , kontollojë sistemin e pagesave që të realizohet sipas kushteve të kontratës për projektet me të cilët është i ngarkuar nga udhëheqësi,
- Kontrollon dhe përcakton tipin dhe kualitetin e materialit që do të përdoret gjatë ekzekutimit të. punimeve, që ti përm bush kushtet sipas standardeve teknike ,
- Të kryej ndonjë detyrë tjetër sipas kërkesës nga mbikëqyrësi.

#### Shkathësitë e kërkua:

- Fakulteti teknik drejtimi : Bachelor i Elektroteknikës ,
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale,
- Përvojë dhe aftesi të mira në programet për Vizatim,
- Njohuri të mirë pune me kompjutor ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ),
- Njohuri për implementimin e sistemeve të BMS për MenaxhiminAutomatik te ndërtesave ,
- Aftesi të mira komunikuese më gojë dhe me shkrim të gjuhës shqipe, e dëshiruesheme e gjuhës angleze dhe sérbokroate,
- Aftesi për punë në ekip, dhe përm bushje të detyrave dhe punëve të vështira.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posidim e të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike nga data e publikimit në ueb faqen e MAP-it dhe shtypin ditor. Paraqitura e kërkuesave: Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e MAP-it, zyrën nr.320 kati i III-të ose mund të tjerhiqen nga web faqja e MAP-it në adresën <http://map.rks-gov.net/> dhe dorëzohen në Divisionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Ndërtesa e ish Rilindjes kati i III-të nr. zyrës 320 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 – 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 30 552.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten:** Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.Datat e mbajtjes së intervistave për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Administratës Publike.

Ministria e Administratës Publike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government  
Ministria e Administratës Publike - Ministerstvo Javne Uprave  
Ministry of Public Administration

Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona Br. 03/ L -149 za Civilnu Službu Republike Kosova „Zakon Br. 04/L-077 za Obligacione Odnose, Ministerstvo Javne Uprave, objavljuje:

### Javni Konkurs o Dogovoru za Posebne Usluge

#### I.Naziv Radnog Mesta: Viši Stručni Nivo (Građevinstvo 1 radnog mesta)

Br.ref.- MAP-DSPIMNQ-2020-1

Funkcionalna Kategorija: Stručni Nivo;

Koeficijent : 8

Vrsta pozicije : Ugovor na delo

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Trajanje imenovanja: na određeno vreme

Radno mesto : Priština, Zgrada bivša,, Rilindja”

#### Cilj radnog mesta:

Da priprema kompletну tehničku dokumentaciju, da nadgleda radove u toku izvođenja i dokumentacije plaćanja za renoviranje projekata ili vladinih zgrada zgrada u centralnom i opštinskom nivou iz građevinske oblasti prema tehničkim standadima na snagu.

**Službenik izveštava kod:** Rukovodilaca Divizije za Upravljanje Vladinim Zgradama

#### Dužnosti i odgovornosti:

1. Da upravlja, nadgleda, kontroliše izvršenje odobrenih planova održavanja,
2. Koordinirati i povećati nivo saradnje i profesionalnosti u obavljanju aktivnosti jedinice i šire,
3. Upravljanje, kontrola i nadzor nad izvršavanjem obaveza koje treba izvršiti usluge, dostavljanje razne robe, periodično ažuriranje zapisa,
4. Priprema projektnu dokumentaciju, uključujući nacrte, proračune, tehničke opise, prethodne mere i kalkulacije, drugu prateću dokumentaciju,
5. Nadgleda građevinske radove na gradilištu projekta i svakodnevno proverava građevinsku knjigu i dnevnik radova,
6. Upravlja, kontrolira platni sistem koji će se sprovesti u skladu sa ugovorom za projekte za koje ga je rugovodilac zadužio,
7. Proverava i određuje vrstu i kvalitet materijala koji će se koristiti tokom izvođenja radova na ispunjavanju zahteva tehničkih standarda,
8. Obavlja i druge poslove koje od njega traži nadzornik.

#### Potrebne veštine:

- Tehnički fakultet, smer : Bachelor Građevinstva,
- Najmanje 2 godine stručnog radnog iskustva,
- Dobro iskustvo i veštine u programu Crtanja,
- Poznavanje rada na kompjuteru ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ),
- Poznavanje primene BMS sistema za automatizovano upravljanje zgradama,
- Dobre usmene i pismene komunikacijske veštine albanskog, poželjno znanje engleskog i srpskog jezika,
- Sposobnost timskog rada, i ispunjavanje zadataka i napornog rada.

#### II.Naziv Radnog Mesta: Viši Stručni Nivo (Arhitektura)

Br.ref.- MAP-DSPIMNQ2020-2

Funkcionalna Kategorija: Stručni Nivo;

Koeficijent : 8

Vrsta pozicije : Ugovor na delo

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Trajanje imenovanja: na određeno vreme

Radno mesto : Priština, Zgrada bivša,, Rilindja”

#### Cilj radnog mesta:

Da priprema kompletну tehničku dokumentaciju, da nadgleda radove u toku izvođenja i dokumentacije plaćanja za renoviranje projekata ili vladinih zgrada zgrada u centralnom i opštinskom nivou iz građevinske oblasti prema tehničkim standadima na snagu.

**Službenik izveštava kod:** Rukovodilaca Divizije za Upravljanje Vladinim Zgradama

#### Dužnosti i odgovornosti:

1. Da upravlja, nadgleda, kontroliše izvršenje odobrenih planova održavanja,
2. Koordinirati i povećati nivo saradnje i profesionalnosti u obavljanju aktivnosti jedinice i šire,
3. Upravljanje, kontrola i nadzor nad izvršavanjem obaveza koje treba izvršiti usluge, dostavljanje razne robe, periodično ažuriranje zapisa,
4. Priprema projektnu dokumentaciju, uključujući nacrte, proračune, tehničke opise, prethodne mere i kalkulacije, drugu prateću dokumentaciju,
5. Nadgleda građevinske radove na gradilištu projekta i svakodnevno proverava

- građevinsku knjigu i dnevnik radova,
- 6. Upravlja, kontrolira platni sistem koji će se sprovesti u skladu sa ugovorom za projekte za koje ga je rugovodilac zadužio,
- 7. Proverava i određuje vrstu i kvalitet materijala koji će se koristiti tokom izvođenja radova na ispunjavanju zahteva tehničkih standarda,
- 8. Obavlja i druge poslove koje od njega traži nadzornik.

#### Potrebne veštine:

- Tehnički fakultet, smer : Bachelor Arhitekture,
- Najmanje 2 godine stručnog radnog iskustva,
- Dobro iskustvo i veštine u programu Crtanja,
- Poznavanje rada na kompjuteru ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ,
- Poznavanje primene BMS sistema za automatizovano upravljanje zgradama,
- Dobre usmene i pismene komunikacijske veštine albanskog, poželjno znanje engleskog i srpskog jezika,
- Sposobnost timskog rada, i ispunjavanje zadataka i napornog rada.

#### III. Naziv Radnog Mesta: Viši Stručni Nivo (Elektrotehnika)

Br.ref.- MAP-DSPIMNQ-2020-3

Funkcionalna Kategorija: Stručni Nivo;

Koeficijent : 8

Vrsta pozicije : Ugovor na delo

Radno vreme: 40 časova nedeljno

Trajanje imenovanja: na određeno vreme

Radno mesto : Priština, Zgrada bivša „Rilindja”

#### Cilj radnog mesta:

Da priprema kompletну tehničku dokumentaciju, da nadgleda radove u toku izvođenja i dokumentacije plaćanja za renoviranje projekata ili vladinih zgrada zgrada u centralnom i opštinskom nivou iz građevinske oblasti prema tehničkim standadima na snagu.

**Službenik izveštava kod:** Rukovodilaca Divizije za Upravljanje Vladinim Zgradama

#### Dužnosti i odgovornosti:

1. Da upravlja, nadgleda, kontroliše izvršenje odobrenih planova održavanja,
2. Koordinirati i povećati nivo saradnje i profesionalnosti u obavljanju aktivnosti jedinice i šire,
3. Upravljanje, kontrola i nadzor nad izvršavanjem obaveza koje treba izvršiti usluge, dostavljanje razne robe, periodično ažuriranje zapisa,
4. Priprema projektnu dokumentaciju, uključujući nacrte, proračune, tehničke opise, prethodne mere i kalkulacije, drugu prateću dokumentaciju,

đ

đ

đ

č

#### Potrebne veštine:

- Tehnički fakultet, smer : Bachelor Građevinstva,
- Najmanje 2 godine stručnog radnog iskustva,
- Dobro iskustvo i veštine u programu Crtanja,
- Poznavanje rada na kompjuteru ( Word, Excel, Internet, Auto Cad ),
- Poznavanje primene BMS sistema za automatizovano upravljanje zgradama,
- Dobre usmene i pismene komunikacijske veštine albanskog, poželjno znanje engleskog i srpskog jezika,
- Sposobnost timskog rada, i ispunjavanje zadataka i napornog rada.

#### Uslovi učestva na konkurs:

đ

č

đ

č

č

č

č

č



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-  
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

## NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURSIT

Bazuar në Raportin Zyrtar Nr. Ri 01/37-245/19, të Inspektoratit të Punës, të datës 23.01.2020, me Nr. Protokoli 250/2020, lidhur me Riinspektimin e zbatimit të vendimit Nr. 01/37-245/19-A, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë 08.08.2019, me Nr. të Ref. 51/2019, për pozitën Arkitekt, në MKRS Prizren.

## OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu Službenog Izveštaja Br. Ri 01 / 37-245 / 19 iz Inspektorata Rada dana 23.01.2020, sa brojem Protokola br. 250/2020, koji se odnosi na ponovnoj inspekciji primene Odluke br.01/37 - 245/19-A, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, objavljuje anuliranje konkursa objavljenog dana 08.08.2019, sa brojem br. Ref. 51/2019, za poziciju Arhitekta, u MKOS-u u Prizrenu.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

## NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURSIT

Bazuar në Rekomandimin e datës 28.01.2020, me Nr. të Protokolit 352/2020, të Komisionit Përgjedhës të Shërbimit Civil, KPSHC, për pozitën, Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Zbatim të Legjislacionit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bënë njoftimin për anulimin e konkursit të shpallur me datë 06.09.2019, me Nr. të Ref. 56/2019, për pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor.

## OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Na osnovu Preporuke dana 28.01.2020, sa Brojem Protokola Br. 352/2020, Izborna Komisija Civilne Službe, SKCS, za radno mesto Viši Pravni Službenik u Diviziji za Primenu Zakonodavstva, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, objavljuje anuliranje konkursa objavljenog dana 06.09.2019, sa brojem Ref. Br. 56/2019, za radno mesto Višeg Pravnog Službenika.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance  
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracijë Kosova - Tax Administration of Kosovo



Zyra për Komunikim Publik / Office of Public Communication / Kancelarija za javne komunikacije

## NJOFTIM PËR TATIMPAGUES

### Konsolidimi i mbledhjes së borxheve

Administrata Tatimore e Kosovës bazuar në nenin 2, të Ligjt Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka përdetyrë të mbledh të hyrat tatimore sipas afateve ligjore të përcaktuara me legjislacionin tatimor, duke pas parasysh rëndësinë e ngritisë së përmbrushes, veçanërisht përmbrushes vullnetare.

Në këtë kontekst ATK është duke punuar në zbatimin e Planit Afatmesëm të Veprimit (PAV) 2019-2021, për modernizimin e administratës tatimore, konkretisht konsolidimin e mbledhjes së detyrueshme.

Me qëllim të rritjes së rezultateve në mbledhjen e borxheve, Administrata Tatimore ka riorganizuar Departamentin e Mbledhjes së Borxheve në një qendër të vetme në Prishtinë, në kuadër të së cilës do të funksionojnë katër divizione, ku secili divizion do të jetë përgjegjës vetëm për një fazë të caktuar të trajtimit të borxheve.

Qëllimi i këtij reformimi është inicuar duke pas parasysh nivelin e borxheve të krijuara nga tatimpaguesit, ku përmes projektit të Konsolidimit të Mbledhjes së Borxheve, ATK do të siguroj procedura dhe qasje të re, në përmirësimin e procesit të trajtimit të borxhit në fazë të hershme, si dhe për të zgjegjësuar stokun e madh të borxheve.

Kjo formë e re organizative do të rrisë efikasitetin e mbledhjes së borxheve, si dhe në të njëjtën kohë do të ngritë nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënie tek stafi i ATK-së.

Bazuar në konsolidimin e mbledhje së detyrueshme, hapat themelor për mbledhjen e borxheve janë trajtimi i shpejtë i borxheve të reja, rritja e ashpersisë së veprimeve në secilin rast të borxhit të papagar, si dhe ndërmarrja e veprimeve ligjore ndaj personave përgjegjës përmes divizioneve përkatëse të specializuara për këto veprime.

Duke u bazuar në misionin, i cili është përmbrushja vullnetare e detyrimeve tatimore, Administrata Tatimore e Kosovës do të punojë në vazhdimësi që të rris bashkëpunimin me tatimpagues. Duke u bazuar në këtë dhe në harmoni me procedurat të parapara ligjore, tatimpaguesve u ofrohet mundësia e marrëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore. Mirëpo, në të njëjtën kohë të gjithë tatimpaguesit të cilët nuk shprehin gatishmëri për shlyerjen e detyrimeve tatimore, do të ndiqen dhe ballafaqohen me veprime ligjore për pagesën e borxheve të krijuara.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Enisi Group" SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 810168569, me pronar Enis Jusufi, rr. Mic Sokoli Vushtrri, ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVEŠTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Enisi Group" D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : 810168569 Enis Jusufi, rr. Mic Sokoli Vushtrri, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacione. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Enisi Group" L.L.C, Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 810168569 Enis Jusufi, rr. Mic Sokoli Vushtrri, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009

**RESTAURANT SWISS TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

P R I S H T I N Ë

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpjete

- >> SHPALLJE TË VOGLA <<**
- 
- Sherif Bali Kabashi shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Edukimit (Shkolla e Lartë Pedagogjike -Gjakovë), me nr. 1959.
- 
- Lulzim Baruti shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 70777630 dhe nr. fis. 810558603.
- 
- Bashkim Muli, shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit individual me numër: 71337855, Vushtrri.
- 
- "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr. Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditore se ka marre vendim për zgogëlimin e kapitalit themelor, zgogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë ) në 5000 Euro.
- 
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- 
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m<sup>2</sup> dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- 
- Lëshoj banës me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- 
- Lëshoj banës me qera për ball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m<sup>2</sup>, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- 
- Lëshoj banës me qira garsoniere në Ulpiana kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjera. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- 
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- 
- Urgjentisht kërkoj një banës me qera në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- 
- Lëshoj lokalini më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- 
- Lëshoj banës me qira në Lagjen Dardania afér "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- 
- Lëshoj banës me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- 
- Lëshoj banës me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- 
- Lëshoj banës me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afér Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- 
- Lëshoj banës me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- 
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afér Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- 
- Lëshoj banës e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m<sup>2</sup>. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 044/44-888-801 (viber)
- 
- Lëshoj banës me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m<sup>2</sup>, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- 
- Lëshoj banës një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kro i Bardhe, banesa është e mobiluar komplet. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- 
- Lëshoj me qira banës e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- 
- Lëshoj banës me qira banës e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- 
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afér AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- 
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i l-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- 
- Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
- Tel. 044-413-197.

# WE

**Thirrje për shprehje të interesit nga institucionet dhe organizata të ndryshme në sektorin e energjisë në Kosovë, për angazhim të praktikanteve në punë, paguar nga MFK.**

## Women in Energy

Gratë në Energji  
Programi i Punës Praktike

Për të gjitha detajet:  
[millenniumkosovo.org/  
womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)

Në kuadër të projektit "Gratë në Energji - Women in Energy", të lansuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës (MFK), së shpejti do të fillojë zbatimi i programit "**Punë praktike për gra në sektorin e energjisë**" i cili ka për synim fuqizimin dhe përfshirjen e gruas në sektorin e energjisë në Kosovë.

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të nevojshme profesionale të grave duke ju ofruar atyre përvojë përmes punës praktike me pagesë në institucionet publike dhe private të sektorit të energjisë në Kosovë. Paga bazike do të ofrohet nga MFK për kohë të caktuar deri në gjashtë muaj.

Përfituese të këtij programi do të janë të gjitha gratë dhe vajzat që shprehin interesim për praktikë në punë në sektorin e energjisë e të cilat janë në vitin e fundit të studimeve Bachelor, studentet e nivelit Master, si dhe ato që kanë diplomuar në tri vitet e fundit por që nuk kanë pasur mundësi të punojnë në profesionet e tyre. Profili i vajzave aplikante do të përfshijë jo vetëm ato që i përkasin fushave STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), por edhe disiplina të tjera të rëndësishme për sektorin e energjisë, të tilla si menaxhimi i projekteve, marketingu dhe financat, ekonomia, legjislacioni, politikë-bërje, teknologjia e informacionit si dhe profile të tjera të nevojshme në këtë sektor.

Andaj, ju bëjmë thirrje të gjitha **institucioneve në sektorin publik dhe privat, organizatave joqeveritare si dhe organizatave ndërkombëtare** të angazhuara në sektorin e energjisë në Kosovë, që kanë nevojë për kontributin e profesionisteve të reja si dhe shprehin interesim për të bashkëpunuar në këtë program të aplikojnë në web faqen tonë:

[millenniumkosovo.org/womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)



**MILLENNIUM  
FOUNDATION  
KOSOVO**



MILLENNIUM  
CHALLENGE CORPORATION  
UNITED STATES OF AMERICA

Gratë në Energji / Programi i Punës Praktike